



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA KUSHTETUESE**  
**USTAVNI SUD**  
**CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 24 korrik 2024  
Nr. ref.:AGJ 2492/24

## **AKTGJYKIM**

në

**rastin nr. KI172/23**

Parashtrues

**Rejhane Ceka**  
**Fiknete Ceka**  
**Lejlane Ceka**  
**Sara Ceka**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit Rev. nr. 216/2023, të 19 qershorit 2023 të Gjykatës Supreme të Kosovës në lidhje me Aktgjykimin Ac. nr. 3023/2020, të 7 prillit 2023, të Gjykatës së Apelit të Kosovës**

### **GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare  
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar  
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare  
Safet Hoxha, gjyqtar  
Radomir Laban, gjyqtar  
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare  
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar  
Enver Peci, gjyqtar dhe  
Jeton Bytyqi, gjyqtar

#### **Parashtruesi i kërkesës**

1. Kërkesa është dorëzuar nga Rejhane, Fiknete, Lejlane dhe Sara Ceka (në tekstin e mëtejshëm: parashtrueset e kërkesës), me vendbanim në fshatin Kaçanik i vjetër në komunën e Kaçanikut, të përfaqësuar nga Shoqata e Avokatëve "Avokatura Istrefi", me avokatët Zaim Istrefi, Arbër Istrefi dhe Jeton Idrizi.

## **Vendimi i kontestuar**

2. Parashtrueset e kërkesës kontestojnë Aktvendimin [Rev. nr. 216/2023], të 19 qershorit 2023 të Gjykatës Supreme të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme) në lidhje me Aktgjykimin [Ac. nr. 3023/2020], të 7 prillit 2023 të Gjykatës së Apelit të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata e Apelit) dhe Aktgjykimin [C. nr. 237/18] të 13 dhjetorit 2020, të Gjykatës Themelore në Ferizaj – dega Kaçanik (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore).

## **Objekti i çështjes**

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktvendimit të kontestuar, me të cilin pretendohet se parashtrueseve të kërkesës iu janë shkelur të drejtat e garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) në lidhje me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ), nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike], nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave], si dhe paragrafët 3 dhe 5 të nenit 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] të Kushtetutës.

## **Baza juridike**

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 20 [Vendimet] dhe 22 [Procedimi i kërkesës] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji), si dhe në rregullin 25 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 01/2023 (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

## **Procedura në Gjykatën Kushtetuese**

5. Më 22 gusht 2023, parashtrueset e kërkesës e dorëzuan kërkesën e tyre në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 1 shtator 2023, Kryetarja e Gjykatës përmes Vendimit [nr. GJR. KI172/23] caktoi gjyqtarin Radomir Laban gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, përmes Vendimit [nr. KSH. KI172/23], të përbërë nga gjyqtarët: Remzije Istrefi-Peci (kryesuese), Nexhmi Rexhepi dhe Enver Peci (anëtarë).
7. Më 7 shtator 2023, Gjykata i njoftoi parashtrueset e kërkesës për regjistrimin e kërkesës.
8. Në të njëjtën ditë, Gjykata ia dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.
9. Më 24 janar 2024, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin paraprak të propozuar nga Gjyqtari raportues dhe vendosi që shqyrtimin e kërkesës ta shtyjë për një seancë të radhës pas plotësimeve shtesë.
10. Më 11 mars 2024, gjyqtari Jeton Bytyqi dha betimin para Presidentes së Republikës së Kosovës, me ç'rast filloi mandati i tij në Gjykatë.
11. Më 30 maj 2024, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe me 2 (dy) vota për dhe 1 (një) kundër, i rekomandoi Gjykatës pranueshmërinë e kërkesës. Në të njëjtën ditë, Gjykata në përbërje të plotë pas këshillimit, vendosi: (i) të

deklarojë, me 8 (tetë) vota për dhe 1 (një) kundër, kërkesën të pranueshme; (ii) të konstatojë, me 5 (pesë) vota për dhe 4 (katër) kundër, se ka pasur shkelje të paragrafit 1 të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 [E drejta për një proces të rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut; (iii), të shpallë të pavlefshëm, me 5 (pesë) vota për dhe 4 (katër) kundër, të pavlefshëm Aktvendimin [Rev. nr. 216/2023], e 19 qershorit 2023, të Gjykatës Supreme të Kosovës dhe (iv) të kthejë, me 5 (pesë) vota për dhe 4 (katër) kundër, Aktvendimin [Rev. nr. 216/2023], të 19 qershorit 2023, të Gjykatës Supreme të Kosovës në rivendosje, në pajtim me konstatimet e Gjykatës.

12. Në përputhje me rregullin 56 (Mendimet mospajtuese) të Rregullores së punës të Gjykatës, gjyqtarët Remzije Istrefi-Peci, Enver Peci dhe Jeton Bytyqi, kanë përgatitur mendim mospajtuës, i cili do të publikohet së bashku me këtë Aktgjykim.

### **Përmbledhja e fakteve**

13. Nga shkresat e lëndës rezulton se më 30 tetor 2018, parashtrueset e kërkesës së bashku me prindërit e tyre, Sh. C. dhe M. C., kishin parashtruar kërkesëpadi për kompensim të dëmit material dhe jomaterial kundër kompanisë së sigurimeve “Elsig Sh. A.” (në tekstin e mëtejshëm: kompania e sigurimeve), për shkak të vdekjes së vëllait të tyre në një aksident të komunikacionit që kishte ndodhur më 8 qershor 2018.
14. Më 13 dhjetor 2019, Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [C. nr. 237/18]:
- I. aprovoi kërkesëpadinë e parashtrueseve të kërkesës dhe prindërve të tyre, ashtu që:
    - a. në emër të dëmit jomaterial, respektivisht dhimbjet shpirtërore për shkak të humbjes së anëtarit të familjes, kompensoi:
      1. Sh. C., babain e të ndjerit shumë prej 10,000 € (dhjetë mijë) euro;
      2. M. C., nënës së të ndjerit shumë prej 10,000 € (dhjetë mijë) euro; si dhe
      3. R. C., motër e të ndjerit [parashtruese e kërkesës] shumë prej 8,000€ (tetë mijë) euro;
      4. F. C., motër e të ndjerit [parashtruese e kërkesës] shumë prej 8,000 € (tetë mijë) euro;
      5. L. C., motër e të ndjerit [parashtruese e kërkesës] shumë prej 8,000 € (tetë mijë) euro;
      6. E. D., motër e të ndjerit shumë prej 8,000 € (tetë mijë) euro;
    - b. në emër të dëmit material për babain e të ndjerit:
      1. shpenzimet e varrimit shumë prej 1,500 € (një mijë e pesëqind) euro, dhe
      2. ngritjen e përmendores shumë prej 1,500 € (një mijë e pesëqind) euro;
    - c. të gjitha këto shuma me kamatë prej 8% (tetë përqind), duke filluar nga 11 dhjetori 2019 e gjerë në pagesën definitive; si dhe
  - II. refuzoi si të pabazuar kërkesëpadinë e parashtrueseve të kërkesës, motrave të të ndjerit, mbi shumat e miratuara në lartësi prej 4,000 € (katër mijë) euro;
  - III. detyroi të paditurën, respektivisht kompaninë e sigurimeve që të paguajnë shumat e përcaktuara në këtë dispozitiv dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 2,396 € (dy mijë e treqind e nëntëdhjetë e gjashtë) euro.

15. Më 21 maj 2020, kompania e sigurimeve parashtrori ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktgjykimit [C. nr. 237/18], të 13 dhjetorit 2019 të Gjykatës Themelore për shkak të (i) shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, (ii) vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, si dhe (iii) zbatimit të gabuar të së drejtës materiale me propozimin që të aprovohet ankesa tij/saj dhe të priset Aktgjykimi i atakuar dhe lënda t'i kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje shkallës së parë.
16. Më 22 maj 2020, Gjykata Themelore përmes Aktvendimit [C. nr. 237/2018] korrigjoi në faqen e parë, në pikën I.A.6. dhe pikën II të dispozitivit, emrin e njëjës nga motrat e të ndjerit, njëkohësisht parashtruese e kërkesës, nga E. D. në S. C.
17. Më 7 prill 2023, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [Ac. nr. 3023/2020]:
- I. refuzoi pjesërisht si të pathemeltë ankesën e kompanisë së sigurimeve ashtu që vërtetoi pikën I të dispozitivit të Gjykatës Themelore sa i përket dëmit material dhe dëmit jomaterial në lidhje me shumat e dedikuara për prindërit e të ndjerit, si dhe pikën III të dispozitivit sa i përket detyrimit për pagesën e shumave të përcaktuara në dispozitiv dhe shpenzimeve të procedurës kontestimore; ndërsa
  - II. aprovoi pjesërisht të themeltë ankesën e kompanisë së sigurimeve në mënyrë që ndryshoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në pikën I të dispozitivit sa i përket dëmit jomaterial për dhimbjet shpirtërore për parashtrueset e kërkesës dhe pikën II të tij, ashtu që zvogëloi shumën prej 8,000 € (tetë mijë euro) të akorduar me Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në shumën prej 5,000 € (pesë mijë euro) për secilën prej motrave të të ndjerit, njëkohësisht parashtruese të kërkesës, me kamatë ligjore prej 8% (tetë përqind) që nga dita e marrjes së aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë si dhe refuzoi si të pathemeltë kërkesëpadinë e parashtrueseve të kërkesës përtej shumave të aprovuara si më lart.
18. Gjykata e Apelit në aktgjykimin e saj, ndër të tjera, arsyetoi si në vijim: *“[...] Gjykata e Apelit gjatë vlerësimit të pretendimeve ankimore të palës së paditur gjeti se qëndrojnë pjesërisht të themelta pretendimet lidhur me kompensimin e dëmit jo material për dhimbjet shpirtërore sa i përket motrave të të ndjerit [E.C.], për arsye se kjo Gjykatë gjen se shumat e aprovuara nga Gjykata e shkallës së parë janë shuma tejet të larta dhe nuk janë në përputhje e praktikën gjyqësore. Gjykata e Apelit vlerëson se shumat e caktuara sikurse në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, pra shuma prej 5,000.00 euro për secilën nga paditëset si motra të ndjerit është shumë adekuate dhe në përputhje me dhimbjet shpirtërore të përjetuara, e po ashtu në përputhje edhe me praktikën gjyqësore.[...]”*
19. Më 25 maj 2023, parashtrueset e kërkesës parashtruan revizion kundër Aktgjykimit [Ac. nr. 3023/2020] të 7 prillit 2023 të Gjykatës së Apelit për shkak të zbatimit të gabuar të dispozitave të së drejtës materiale, me propozimin që Gjykata Supreme ta ndryshojë Aktgjykimin e lartcekur të Gjykatës së Apelit, ashtu që ta lë në fuqi Aktgjykimin e shkallës së parë. Në revizionin e tyre, parashtrueset e kërkesës, ndër të tjera, pretenduan: *“[...] shumat e ndryshuara sipas aktgjykimit të atakuar nuk përputhen me intensitetin e dhimbjeve të cilat i kanë përjetuar paditëset [parashtrueset e kërkesës], ndërsa shumat e gjykuara nga Gjykata e shkallës së parë janë adekuate me intensitetin e dhimbjeve të cilën e kanë përjetuar paditëset dhe ato do të sadopak në zbutjen e pasojave negative që janë paraqitur në rastin e shkaktimit të këtyre dhimbjeve, e që këto dhimbje shpirtërore janë të pranishme edhe sot e kësaj dite”*.

20. Më 19 qershor 2023, Gjykata Supreme përmes Aktvendimit [Rev. nr. 216/2023] hodhi si të palejuar revizionin e parashtrueseve të kërkesës kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit. E njëjta në aktvendimin e saj iu referua dispozitave të Ligjit nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore (në tekstin e mëtejshëm: LPK), respektivisht paragrafit 2 të nenit 211, i cili përcakton: “211.2 Revizioni nuk është i lejuar në kontestet pasurore-juridike, në të cilat kërkesëpadia ka të bëjë në të holla, me dorëzimin e sendit ose me kryerjen e ndonjë veprimi, nëse vlera e objektit të kontestit në pjesën e goditur të aktgjykimit nuk kalon shumën 3,000 Euro” si dhe nenit 211 të Ligjit nr. 04/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e LPK-së, ku paragrafi 2 i nenit 218 të LPK-së, ndër të tjera, ndryshohet si në vijim: “2. Revizioni është i palejueshëm nëse: a) e ka paraqitur personi i cili nuk është i autorizuar për paraqitjen e revizionit; b) revizionin e ka paraqitur personi i cili e ka tërhequr revizionin; c) nëse personi i cili ka paraqitur revizionin nuk ka interes për paraqitjen e tij; d) është paraqitur kundër aktgjykimit kundër të cilit sipas ligjit nuk mund të paraqitet”.
21. Po ashtu, Gjykata Supreme në aktvendimin e saj arsyetoi si më poshtë:

*“Ndërsa paditësit nuk kanë ushtruar ankesë kundër aktgjykimit të shkallës së parë, andaj në pjesën refuzuese aktgjykimi i shkallës së parë ka marrë formën e prerë në momentin e kalimit të afatit të ankesës, pasi pala e paditur në pjesën refuzuese nuk ka goditur aktgjykimin e shkallës së parë, ndërsa nga gjykata e shkallës së dytë aktgjykimi i shkallës së parë në pjesën refuzuese nuk është shqyrtuar, andaj në këtë pjesë nuk mund të goditet fare me revizion. [...]*

*[...] dispozitat e cituara i referohen lejueshmërisë së revizionit e kushtëzuar me vlerën e kontestit e cila duhet të jetë mbi 3,000 (tre mijë) euro, për të qenë i lejuar revizioni, dhe situatës kur revizioni lejohet pavarësisht vlerës së kontestit sipas kriterit përjashtues për natyrën e çështjes kontestuese. Në këtë rast vlera e kontestit në pjesën e refuzuar nga gjykata e shkallës së dytë për paditësit për secilën kërkesë veç e veç të tyre është dhe atë: paditëses [R.C], motra e të ndjerit në shumën prej 3,000 €, paditëses [F.C], motra e të ndjerit në shumën prej 3,000 €, paditëses [L.C], motra e të ndjerit në shumën prej 3,000 €, paditëses [S.C.], motra e të ndjerit në shumën prej 3,000 €, e që nuk e kalon shumën prej 3,000 € për asnjërin prej paditësve. Në këtë çështje kemi të bëjmë me bashkëndërgjyqës të thjeshtë, ku pozita procedurale e një bashkëndërgjyqësi nuk varet nga pozita procedurale e bashkëndërgjyqësve tjerë. Në bazë të nenit 268 të LPK-së, çdo njeri nga këta është i pavarur në gjykim dhe se vlera e kontestit merret veç e veç për çdo njeri prej tyre”.*

### **Pretendimet e parashtruesit të kërkesës**

22. Parashtrueset e kërkesës pretendojnë se me aktvendimin e kontestuar iu janë shkelur të drejtat e tyre të mbrojtura me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike], nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave], si dhe paragrafët 3 dhe 5 të nenit 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] të Kushtetutës.
23. Në lidhje me këtë, parashtrueset e kërkesës theksojnë: “[...] mosshqyrtimi i mjetit juridik nga Gjykata Supreme, respektivisht hedhja e mjetit juridik si “i palejuar”, për shkak të shkeljeve të dispozitave ligjore nga Gjykata Supreme, ka shkaktuar mosrespektim të parimit të barabarësisë së mjeteve nga palët në procedurë [...].
24. Më specifikisht, parashtrueset e kërkesës konsiderojnë se: “Gjykata e Supreme me Aktvendimin e lartcekur ka vepruar sikur kemi të bëjmë me aktgjykime të ndara kur ka llogaritur vlerën e objektit të kontestit, Gjykata e Supreme gabimisht i ka

*interpretuar këto dispozita ligjore, pasi që vlera e objektit të kontestit me të cilën është lidhur Gjykata Supreme kalon vlerën mbi 3,000.00 € (që në kontestet pasurore - juridike, është kusht për të ushtruar revizion), duke pasur parasysh vlerën e përgjithshëm të objektit të kontestit të cekur edhe në vendimin e gjykatës së shkallës së parë, pasi që nuk kemi të bëjmë me konteste të ndara por me një të vetme dhe si vlerë e objektit të kontestit konsiderohet vlera e përgjithshme, andaj një përfundim i tillë nga Gjykata Supreme e Kosovës është në tërësi në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Procedurë Kontestimore”.*

25. Për më tepër, parashtrueset e kërkesës thirren në paragrafin 1 të nenit 30 dhe paragrafin 1 të nenit 32 të LPK-së me pretendimin se kërkesat e parashtrueseve të kërkesës janë të mbështetura në të njëjtën bazë juridike dhe faktike, pasi që ndërlidhen me një të paditur dhe me kërkesa të njëjta për të gjithë paditësit. Në lidhje me këtë, parashtrueset e kërkesës nënvizojnë se: *“Gjykata Supreme me Aktvendimin e lartcekur iu është referuar gabimisht dispozitave ligjore të Ligjit për Procedurë Kontestimore, pasi që në arsyetim të këtij vendimi Gjykata Supreme ka vepruar sikur të kemi të bëjmë me konteste të ndara, po ashtu ka interpretuar gabimisht edhe dispozitat ligjore të nenit 268 të LPK-së, [Secili bashkëndërgjyqës në procesin kontestimor është palë në vete dhe kryerja apo moskryerja e veprimeve të tilla procedurale, as nuk i shkojnë në favor e as në dëm bashkëndërgjyqësve të tjerat]. Kjo dispozitë e cila është theksuar në arsyetim të aktvendimit të Gjykatës Supreme, nuk ndërlidhet fare me objektin e kësaj çështje kontestimore, kjo dispozitë kuptohet si dispozitë e përgjithshme lidhur me pozitën procedurale të bashkëndërgjyqësve, si dhe veprimet procedurale dhe efektet e këtyre veprimeve brenda institutit të bashkëndërgjyqësisë. Pra ky nen, parimisht, në mënyrë të përgjithshme, ka përcaktuar që bashkëndërgjyqësit në procesin kontestimor janë palë të pavarura, dhe se kryerja apo moskryerja e veprimeve procedurale nga ana e ndonjërit prej bashkëndërgjyqësve, nuk i shkojnë as në dobi dhe e as në dëm bashkëndërgjyqësve të tjerë. Me këtë dispozitë rregullohet e ashtuquajtura bashkëndërgjyqësi e thjeshtë, ku ndaj çdonjërit bashkëndërgjyqësit, gjykata mund të jap vendim të ndryshme apo vendime me përmbajtje të ndryshme. Ky nen kuptohet si dispozitë e përgjithshme dhe parimisht si e tillë, sepse jo në të gjitha rastet mund të kuptohet dhe të aplikohet si e tillë. Kjo për faktin se, në disa raste kur sipas ligjit ose për shkak të natyrës së veçantë të ndonjë marrëdhënie juridike, kontesti lidhur me të, mund të zgjidhet në mënyrën e njëjtë ndaj të gjithë bashkëndërgjyqësve. Me këtë rast, ata të gjithë konsiderohen si një palë e vetme ndërgjyqëse, dhe rrjedhimisht kur ndonjëri nga bashkëndërgjyqësit nuk e kryen ndonjë veprim procedural, efekti i veprimeve procedurale të kryera nga ana e bashkëndërgjyqësit tjetër shtrihen edhe në ata që nuk i kanë kryer veprimet e tilla procedurale. Në rast se, veprimet e kryera procedurale të bashkëndërgjyqësve dallohen mes tyre (nuk janë të bashkërenduar në aspektin përmbajtësor), atëherë gjykata do ta marr në konsideratë atë veprim më të favorshëm procedural që është për të gjithë bashkëndërgjyqësit”.*
26. Në fund, parashtrueset e kërkesës kërkojnë nga Gjykata që: (i) të konstatojë shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, neneve 32, 54 dhe 102 të Kushtetutës; (ii) të shpallë të pavlefshëm Aktvendimin [Rev. nr. 216/2023] të 19 qershorit 2023 të Gjykatës Supreme; si dhe (iii) të kthejë lëndën në Gjykatën Supreme për ta lejuar revizionin e parashtrueseve të kërkesës ashtu që ta ndryshojë Aktgjykimin [Ac. nr. 3023/20] të 7 prillit 2023 të Gjykatës së Apelit dhe ta lë në fuqi Aktgjykimin [C. nr. 237/18] të 10 janarit 2020 të Gjykatës Themelore.

## **Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore**

### **KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

#### **Neni 31**

#### **[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]**

- “1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.*
- 2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.*
- 3. Gjykimi është publik, me përjashtim të rasteve kur gjykata, në rrethana të veçanta, konsideron se, në të mirë të drejtësisë, është i domosdoshëm përjashtimi i publikut, ose i përfaqësuesve të mediave, sepse prania e tyre do të përbënte rrezik për rendin publik ose sigurinë kombëtare, interesat e të miturve, ose për mbrojtjen e jetës private të palëve në proces, në mënyrën e përcaktuar me ligj.*
- 4. Çdokush i akuzuar për vepër penale ka të drejtë t'u bëjë pyetje dëshmitarëve dhe të kërkojë paraqitjen e detyrueshme të dëshmitarëve, të ekspertëve dhe të personave të tjerë, të cilët mund të sqarojnë faktet.*
- 5. Çdokush i akuzuar për vepër penale, prezumohet të jetë i pafajshëm derisa të mos dëshmohet fajësia e tij/saj, në pajtim me ligjin”.*

#### **Neni 32**

#### **[E Drejta për Mjete Juridike]**

*“Secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me ligj”.*

#### **Neni 54**

#### **[Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave]**

*“Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur”.*

#### **Neni 102**

#### **[Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor]**

- “1. Pushteti gjyqësor në Republikën e Kosovë ushtrohet nga gjykatat.*
- 2. Pushteti gjyqësor është unik, i pavarur, i drejtë, apolitik e i paanshëm dhe siguron qasje të barabartë në gjykata.*
- 3. Gjykatat gjykojnë në bazë të Kushtetutës dhe ligjit.*
- 4. Gjyqtarët gjatë ushtrimit të funksionit të tyre duhet të jenë të pavarur dhe të paanshëm.*
- 5. Garantohet e drejta për ankesë ndaj një vendimi gjyqësor, përveç nëse me ligj është përcaktuar ndryshe. E drejta e përdorimit të mjeteve të jashtëzakonshme juridike, rregullohet me ligj. Me ligj mund të lejohet e drejta për të referuar një rast në mënyrë të drejtpërdrejtë në Gjykatën Supreme, dhe për të tilla raste nuk ka të drejtë ankese”.*

## KONVENTA EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

### Neni 6 (E drejta për një proces të rregullt)

*“1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohej shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.  
[...]*”

### LIGJI Nr. 03/L-006 PËR PROCEDURËN KONTESTIMORE

#### 4. Përcaktimi i vlerës së objektit të kontestit

##### Neni 30 (pa titull)

*“30.1 Padiësi ka për detyrë që, në kontestet pasurore-juridike, në padi ta përcaktoj vlerën e objektit të kontestit. Si vlerë e objektit të kontestit merret parasysht vetëm vlera e kërkesës kryesore.*

*30.2 Kamatat, shpenzimet procedurale, penalitetet e kontraktuara dhe kërkesat tjera ankesore, nuk merren parasysht në qoftë se nuk përbëjnë kërkesë kryesore.”*

##### Neni 32 (pa titull)

*“32.1 Në qoftë se një padi e ngritur kundër një të padituri përfshihen disa kërkesa që mbështeten në të njëjtën bazë faktike dhe juridike, atëherë vlera e objektit të kontestit caktohet sipas shumës së përgjithshme të vlerës së të gjitha kërkesave.*

*32.1 Në qoftë se kërkesat në padi rezultojnë nga baza të ndryshme, apo në qoftë se janë ngritur kundër disa të paditurve, vlera e objektit të kontestit caktohet sipas vlerës së secilës kërkesë veç e veç.”*

##### Neni 36 (pa titull)

*“Në qoftë se padiësi nuk e ka përmendur fare vlerën e objektit të kontestit në padinë e paraqitur në gjykatë, apo në qoftë se ai vlerën e tillë e ka caktuar tepër të lartë apo shumë më të vogël se që është ajo realisht, atëherë gjykata sipas detyrës zyrtare, apo sipas prapësimit të palës së paditur, më së voni në seancën përgatitore, e nëse kjo nuk është mbajtur, atëherë në seancën për shqyrtimin kryesor të çështjes juridike, por para se të fillojë shqyrtimi i çështjes kryesore, shpejtë dhe në mënyrë të përshtatshme do ta caktoj, përkatësisht do ta verifikojë saktësinë e vlerës së treguar në padi nga padiësi. Në rast të këtillë gjykata vendosë me aktvendim kundër të cilit nuk lejohet ankimi.”*



**KREU XIV**  
**MJETET E JASHTËZAKONSHME TË GODITJES**

**REVIZIONI**

**Neni 211**  
**(pa titull)**

“[...]

211.2 Revizioni nuk lejohet në kontestet pasurore-juridike në të cilat kërkesëpadia ka të bëjë me kërkesat në të holla, me dorëzimin e sendit, ose me përmbushjen e ndonjë premtimi tjetër, po që se vlera e objektit të kontestit në pjesën e goditur të aktgjykimit nuk i kalon 3.000 Euro.

211.3 Revizioni nuk lejohet në kontestet pasurore-juridike në të cilat kërkesëpadia nuk ka të bëjë me kërkesat në para, me dorëzimin e sendit apo me përmbushjen e ndonjë premtimi tjetër, po që se vlera e objektit të kontestit e treguar në padinë e paditësit nuk e kalon shumën prej 3.000 Euro [...]”

**Neni 214**  
**(pa titull)**

214.1 Revizioni mund të paraqitet:

a) për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 188 i këtij ligji e cila është bërë në procedurën e gjykatës së shkallës së dytë;

b) për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale;

c) për shkak të tejkalimit të kërkesëpadisë, po që se kjo parregullsi është bërë në procedurën e zhvilluar në gjykatën e shkallës së dytë.

214.2 Revizioni nuk mund të paraqitet për shkak të konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike.

[...]”

**KREU XVI**  
**BASHKËNDËRGJYQËSIA**

**Neni 268**  
**(pa titull)**

“Secili bashkëndërgjyqës në procesin kontestimor është palë në vete dhe kryerja apo moskryerja e veprimeve të tilla procedurale, as nuk i shkojnë në favor e as në dëm bashkëndërgjyqësve të tjerë.”

**Neni 269**  
**(pa titull)**

“269.1 Në qoftë se sipas ligjit ose për shkak të natyrës së raportit juridik kontesti mund të zgjidhet vetëm në mënyrë të njëjtë ndaj të gjithë bashkëndërgjyqësve (bashkëndërgjyqësia unike), atëherë ata të gjithë konsiderohen si një palë ndërgjyqëse e vetme, kështu që në rastin kur ndonjëri nga bashkëndërgjyqësit nuk e kryen ndonjë veprim procedural, efekti i veprimeve procedurale të kryera nga bashkëndërgjyqësi tjetër shtrihet edhe në ata që nuk i kanë kryer veprimet e tilla.

269.2 Po që se bashkëndërgjyqësit kryejnë veprime procedurale që dallohen mes tyre, atëherë gjykata e merr në konsiderim atë veprim procedural që është për të gjithë ata më i favorshmi.”

**LIGJI NR. 04/L-118 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 03/L-006 PËR PROCEDURËN KONTESTIMORE**

**Neni 11  
(pa titull)**

*“Neni 218 i ligjit bazik riformulohet me tekstin si në vijim:*

*Neni 218*

- 1. Revizioni i paraqitur pas kohe, i palejueshëm apo jo i plotë, hedhet poshtë me aktvendim të Gjykatës së shkallës së parë pa mbajtur seancë gjyqësore.*
- 2. Revizioni është i palejueshëm nëse:*
  - a) e ka paraqitur personi i cili nuk është i autorizuar për paraqitjen e revizionit;*
  - b) revizionin e ka paraqitur personi i cili e ka tërhequr revizionin;*
  - c) nëse personi i cili ka paraqitur revizionin nuk ka interes për paraqitjen e tij;*
  - d) është paraqitur revizioni kundër aktgjykimit kundër të cilit sipas ligjit nuk mund të paraqitet”.*

**Vlerësim i pranueshmërisë së kërkesës**

27. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
28. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:
  - “1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.  
[...]*
  - 7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.*
29. Gjykata gjithashtu i referohet nenit 47 [Kërkesa individuale], nenit 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe nenit 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

**Neni 47  
[Kërkesa individuale]**

*“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.*

*2. Individ i mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të këtë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”*

**Neni 48  
[Saktësimi i kërkesës]**

*“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.*

**Neni 49**

[Afatet]

*“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor”.*

30. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kritereve, Gjykata konstaton se parashtrueset e kërkesës janë: (i) palë të autorizuara; (ii) kontestojnë një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktvendimin [Rev. nr. 216/2023] të 19 qershorit 2023 të Gjykatës Supreme në lidhje me Aktgjykimin [Ac. nr. 3023/2020] të 7 prillit 2023, të Gjykatës së Apelit dhe Aktgjykimin [C. nr. 237/18] të 13 dhjetorit 2020, të Gjykatës Themelore; (iii) kanë saktësuar të drejtat dhe liritë që pretendojnë se iu janë shkelur; (iv) kanë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj; si dhe (v) e kanë dorëzuar kërkesën brenda afatit të përcaktuar ligjor.
31. Gjykata gjithashtu thekson se kërkesa nuk është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin 2 të rregullit 34 të Rregullores së punës, prandaj ajo duhet deklaruar e pranueshme dhe duhet të shqyrtohen meritat e saj.

### **Meritat**

32. Fillimisht, Gjykata rikujton që rrethanat e rastit konkret ndërlidhen me kërkesëpadinë e parashtrueseve të kërkesës dhe të prindërve të tyre, kundër kompanisë së sigurimeve, për kompensim të dëmit material dhe jomaterial për shkak të vdekjes së vëllait të tyre në aksident komunikacioni, i cili ishte i siguruar në këtë kompani. Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [C. nr. 237/18] të 13 dhjetorit 2020, kishte aprovuar kërkesëpadinë e tyre si dhe të prindërve të tyre sa i përket kompensimit të dëmit material dhe jomaterial, ku për dëmin jomaterial, parashtrueset e kërkesës u kompensuan veç e veç në shumën në lartësi prej 8,000 € (tetë mijë euro), ndërsa secili prind në lartësi prej 10,000 € (dhjetë mijë euro). Si rezultat i ankesës së kompanisë së sigurimeve, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [Ac. nr. 3023/2020] të 7 prillit 2023, vërtetoi kompensimin për dëmin material dhe atë jomaterial në lidhje me prindërit e parashtrueseve të kërkesës, ndërsa ndryshoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore, duke zbritur shumën nga 8,000 € (tetë mijë euro) në 5,000 € (pesë mijë euro) për secilën nga parashtrueset e kërkesës. Parashtrueset e kërkesës parashtruan revizion kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, të cilin Gjykata Supreme përmes Aktvendimit [Rev. nr. 216/2023] të 19 qershorit 2023, e hodhi poshtë si të palejuar me arsyetimin se vlera e objektit të kontestit në pjesën e goditur të aktgjykimit nuk e kalon shumën prej 3,000 € (tre mijë euro) për secilën prej tyre, dhe se të njëjtat i konsideroi bashkëndërgjyqëse të thjeshta, ku pozita procedurale e një bashkëndërgjyqësi nuk varet nga pozita procedurale e bashkëndërgjyqësve tjerë, andaj, edhe vlera e kontestit merret veç e veç për çdo njërin prej tyre.
33. Parashtrueset e kërkesës, në kërkesën e tyre para Gjykatës kontestojnë konstatimin e lartcekur të Gjykatës Supreme se revizioni i tyre ishte i palejuar, duke pretenduar se ky konstatim përbën shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të tyre të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, nenet 32, 54 si dhe paragrafët 3 dhe 5 të nenit 102 të Kushtetutës. Kjo për shkak se, sipas tyre, vlera e objektit të kontestit të tyre e kalon vlerën prej 3,000 € (tre mijë euro), me arsyetimin që kërkesat e tyre nuk janë konteste të ndara por përbëjnë një kërkesë të vetme, ndër të tjera, sepse mbështeten në të njëjtën bazë juridike dhe faktike dhe ndërlidhen me një të paditur, si dhe përmbajnë kërkesa të njëjta për të gjithë paditësit.

34. Në vijim të pretendimit të parashtrueseve të kërkesës, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë. Në këtë aspekt, Gjykata fillimisht vë në dukje se çështja e refuzimit apo moslejimit të revizionit për shkak se e njëjta nuk e arrin vlerën e përcaktuar me ligj hyn në kuadër të parimit apo të drejtës për qasje në gjykatë, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së (shih, rastin e Gjykatës, KI96/22, parashtrues *Naser Husaj dhe Uliks Husaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 29 gushtit 2023, paragrafi 49).
35. Rrjedhimisht, mohimi i të drejtës për qasje në gjykatë, ka për pasojë edhe mohimin e mjetit efektiv juridik dhe të mbrojtjes gjyqësore të të drejtave, të cilat të drejta parashtrueset e kërkesës gjithashtu pretendojnë se iu janë shkelur nga konkluzionet arbitrare të Gjykatës Supreme, në lidhje me vlerësimin e vlerës së objektit të kontestit, si parakusht për të vlerësuar meritat e rastit (shih, rastin e Gjykatës, [KI143/21](#), parashtrues *Avdyl Bajgora*, Aktgjykim i 25 nëntorit 2021, paragrafi 60).
36. Gjykata në vijim të kësaj i referohet konstatimit të Gjykatës Supreme se revizioni i tyre ishte i palejuar për shkak të vlerës së objektit të kontestit, andaj do të shqyrtojë pretendimin e parashtrueseve që ndërlidhet me çështjen e lejueshmërisë së revizionit.
37. Në kontekst të pretendimit të lartcekur, parashtrueset e kërkesës theksojnë: *“Gjykata e Supreme me aktvendimin e lartcekur ka vepruar sikur kemi të bëjmë me aktgjykime të ndara kur ka llogaritur vlerën e objektit të kontestit, Gjykata Supreme gabimisht i ka interpretuar këto dispozita ligjore, pasi që vlera e objektit të kontestit me të cilën është lidhur Gjykata Supreme kalon vlerën mbi 3,000.00 € (që në kontestet pasurore - juridike, është kusht për të ushtruar revizion), duke pasur parasysh vlerën e përgjithshme të objektit të kontestit të cekur edhe në vendimin e gjykatës së shkallës së parë, pasi që nuk kemi të bëjmë me konteste të ndara por me një të vetme dhe si vlerë e objektit të kontestit konsiderohet vlera e përgjithshme, andaj një përfundim i tillë nga Gjykata Supreme e Kosovës është në tërësi në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Procedurë Kontestimore”*.
38. Thënë këtë, rrethanat e rastit konkret ndërlidhen me atë nëse Gjykata Supreme duke e shpallur *“të palejuar revizionin”* përmes interpretimit të dispozitave procedurale në mënyrë tejet formaliste duke afektuar në mënyrë disproporcionale mundësinë e parashtrueseve të kërkesës për të marrë një vendim merititor të rastit të tyre nga ana e Gjykatës Supreme (shih, rastin e Gjykatës, KI96/22, parashtrues *Naser Husaj dhe Uliks Husaj*, cituar më lart, paragrafi 50).
39. Në vijim, dhe në kontekstin e lartcekur, Gjykata fillimisht do të i referohet Aktgjykimit të Dhomës së Madhe të GJEDNJ-së, [Zubac kundër Kroacisë](#) [nr. 40160/12, Aktgjykim i 5 prillit 2018], i cili, ndër tjerash, ka vendosur parimet e përgjithshme përkitazi me çështjen e lejueshmërisë së revizionit e që ndërlidhet me pragun e vlerës së përcaktuar me ligj. Për shkak të relevancës së këtij rasti në raport me rrethanat e rastit konkret, Gjykata shkurtimisht thekson faktet e rastit *Zubac kundër Kroacisë*, ku parashtrueses iu kishte hedhur poshtë revizioni nga Gjykata Supreme e Kroacisë. Më konkretisht, në këtë rast parashtruesja kishte ngritur padi civile, lënda e së cilës u vlerësua nga avokati i saj i parë në vlerën prej 10,000 HRK (dhjetë mijë kuna) apo rreth 1,400 € (një mijë e katërqind euro), të cilën vlerë më pas në seancën përgatitore pas ndërrimit të avokatit, e rivlerësoi në 105,000 HRK (njëqind e pesë mijë kuna). Megjithatë, *“padi civile”* e përmendur në padi mund të ndryshohej vetëm me një vendim gjyqësor të posaçëm, i cili nuk ishte më i mundur në atë fazë dhe pavarësisht që gjykatat kishin përdorur shifrën e re në llogaritjen e tarifave gjyqësore, revizioni i

parashtrueses u hodh poshtë si i palejuar nga Gjykata Supreme, me arsyetimin se vlera e kontestit nuk arrin pragun e vlerës së përcaktuar me ligj për të parashtruar revizion për shkak se ndryshimi i vlerës së kontestit përmes dokumentit të kërkesës së shkallës së parë nuk ishte ndryshuar në mënyrë të vlefshme atë. Në këtë rast, GJEDNJ nuk gjeti shkelje të paragrafit 1 të nenit 6 të KEDNJ-së, por gjatë vlerësimit të tij zhvilloi disa kritere të cilat më pas janë aplikuar nga kjo gjykatë, ndër të tjera, në rastet si në vijim: [Jureša kundër Kroacisë](#) [nr. 24079/11, Aktgjykim i 22 majit 2018, paragrafët 41-45], [Lazarević kundër Bosnjë dhe Hercegovinës](#) [nr. 29422/17, Aktgjykim i 14 janarit 2020, paragrafët 28-35] dhe [Makrylakis kundër Greqisë](#) [nr. 34812/15, Aktgjykim i 17 nëntorit 2022, paragrafët 36-52].

40. Duke ndjekur logjikën e rastit të GJEDNJ-së, *Zubac kundër Kroacisë*, Gjykata do të në paraqesë fillimisht (i) përmbledhjen e parimeve përkatëse, respektivisht (a) parimet e përgjithshme të GJEDNJ-së për qasje në gjykatë për aq sa janë relevante në rrethanat e rastit konkret; dhe (b) parimet e përgjithshme për qasje në gjykatat e larta dhe kufizimet *ratione valoris* në këtë drejtim, përfshirë sipas parimeve të zhvilluara në rastin *Zubac kundër Kroacisë* dhe më pas duke (ii) aplikuar këto parime në rrethanat e rastit konkret.

#### **(a) Parimet e përgjithshme për qasje në gjykatë**

41. E drejta e qasjes në gjykatë është pjesë përbërëse e të drejtës në gjykim të drejtë dhe të paanshëm sipas paragrafit 1 të nenit 6 të KEDNJ-së. Parimet themelore lidhur me këtë të drejtë janë përcaktuar në rastin e GJEDNJ-së, [Golder kundër Mbretërisë së Bashkuar](#) [nr. 4451/70, Aktgjykim i 21 shkurtit 1975, paragrafët 28-36]. Në atë rast, GJEDNJ konstatoi se e drejta e qasjes në gjykatë ishte një aspekt i qenësishëm i garancive të mishëruara në nenin 6 të KEDNJ-së, duke iu referuar parimeve të sundimit të ligjit dhe shmangies së pushtetit arbitrar që është bazë e pjesës më të madhe të parimeve ngërthen KEDNJ. Kështu, paragrafi 1 i neni 6 të KEDNJ-së i siguron secilit të drejtën për të pasur një zgjidhje lidhur me një kërkesë në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij civile në gjykatë (shih rastet e GJEDNJ-së, [Roche kundër Mbretërisë së Bashkuar \[DHM\]](#), nr. 32555/96, Aktgjykim i 19 tetorit 2005, paragrafi 116, shih [gjithashtu Z dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar \[DHM\]](#), nr.29392/95, Aktgjykim i 10 majit 2001, paragrafi 91, [Cudak kundër Lituanisë \[DHM\]](#), nr.15869/02, Aktgjykim i 23 marsit 2010, paragrafi 54, G; dhe [Famullia Katolike Greke Lupeni dhe të tjerët kundër Rumanisë \[DHM\]](#), nr.76943/11, Aktgjykim i 29 nëntorit 2016, paragrafi 84 (ekstrakte)).
42. Sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, e drejta e qasjes në gjykatë duhet të jetë “*praktike dhe efektive*”, jo “*teorike apo iluzore*” (shih, për këtë qëllim, [Bellet kundër Francës](#), [nr.42527/98 Aktgjykim i 4 dhjetorit 1995, paragrafi 36). Ky vëzhgim është veçanërisht i vërtetë në lidhje me garancitë e parapara me nenin 6 të KEDNJ-së, duke pasur parasysh vendin e spikatur që ka e drejta për një gjykim të drejtë në një shoqëri demokratike (shih, rastet e GJEDNJ-së [Princi Hans-Adam II i Lihtenshtajnit kundër Gjermanisë \[DHM\]](#), nr. 42527/98, Aktgjykim i 12 korrikut 2001, paragrafi 45, dhe [Famullia Katolike Greke Lupeni dhe të tjerët kundër Rumanisë \[DHM\]](#)], cituar më lart, paragrafi 86).
43. Megjithatë, e drejta e qasjes në gjykatë nuk është absolute, por mund t’i nënshtrohet kufizimeve dhe të cilat, lejohen në mënyrë të nënkuptuar pasi e drejta e qasjes nga vetë natyra e saj kërkon rregullim nga Shteti, i cili rregullim mund të ndryshojë në kohë dhe në vend, në varësi të nevojave dhe burimeve të komunitetit dhe të individëve (shih, [Stanev kundër Bullgarisë \[DHM\]](#), nr. 36760/06, Aktgjykim i 17 janarit 2012, paragrafi 230). Në përcaktimin e një rregullimi të tillë, Palët Kontraktuese të KEDNJ-së gëzojnë

një liri të caktuar vlerësimi. Megjithatë, kufizimet e aplikuara nuk duhet të kufizojnë qasjen që i është lënë individit në një mënyrë ose në atë masë që të cenohet vetë thelbi i së drejtës. Për më tepër, një kufizim nuk do të jetë në përputhje me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ-së nëse ai nuk ndjek një qëllim legjitim dhe nëse nuk ka një marrëdhënie të arsyeshme të proporcionalitetit midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit që kërkohet të arrihet (shih, rastin e GJEDNJ-së, [Famullia Katolike Greke Lupeni dhe të tjerët kundër Rumanisë \[DHM\]](#) cituar më lart, paragrafi 89, me referenca të mëtejshme).

44. GJEDNJ në praktikën e saj po ashtu ka theksuar se nuk është detyrë e saj të merret me gabimet e fakteve ose ligjit që pretendohet të jenë bërë nga një gjykatë kombëtare, përveç nëse dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me KEDNJ-në (shih, ndër të tjera, [García Ruiz kundër Spanjës \[DHM\]](#), nr. 30544/96, Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 28 dhe [Perez kundër Francës \[DHM\]](#), nr. 47287/99, Aktgjykim i 12 shkurtit 2004, paragrafi 82). Normalisht, çështje të tilla si peshat që gjykatat kombëtare u japin provave të dhëna ose gjetjeve ose vlerësimeve që janë para tyre për t'u shqyrtuar, nuk duhet të shqyrtohen nga GJEDNJ sepse ajo nuk duhet të veprojë si shkallë e katërt dhe për këtë arsye nuk do të vërë në dyshim aktgjykimin e gjykatave kombëtare sipas paragrafit 1 të nenit 6 të KEDNJ-së, përveç rasteve kur gjetjet e tyre mund të konsiderohen si “arbitrare ose qartazi të paarsyeshme” (shih, ndër tjerash, [Bochan kundër Ukrainës \(nr. 2\) \[DHM\]](#), nr. 22251/08, Aktgjykim i 5 shkurtit 2015, paragrafi 61).

**(b) Parimet e përgjithshme për qasje në gjykatat e larta në raport me kufizimet *ratione valoris***

45. Sipas sqarimeve të dhëna përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, neni 6 i KEDNJ-së, nuk i detyron Palët Kontraktuese të krijojnë gjykata të apelit ose të kasacionit. Megjithatë, aty ku ekzistojnë gjykata të tilla, duhet të respektohen garancitë e nenit 6 të KEDNJ-së, për shembull në atë që u garanton palëve ndërgjyqëse një të drejtë efektive të qasjes në gjykata për përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tyre civile (shih, rastet e Gjykatës, [Andrejeva kundër Letonisë \[DHM\]](#), nr. 55707/00, Aktgjykim i 18 shkurtit 2009, paragrafi 97; shih gjithashtu, [Levages Prestations Services kundër Francës](#), nr. 21920/93 Aktgjykim i 23 tetorit 1996, paragrafi 44, Raportet e aktgjyqimeve dhe vendimeve 1996-V; [Brualla Gómez de la Torre kundër Spanjës](#), nr. 155/1996/774/975 Aktgjykim i 19 dhjetorit 1997, paragrafi 37, Raportet 1997-VIII, dhe [Annoni di Gussola dhe të tjerët kundër Francës](#), nr. 31819/96 dhe 33293/96, NR. Aktgjykim i 14 shkurtit 2001, paragrafi 54).
46. Sipas praktikës së saj gjyqësore, megjithatë, nuk është detyrë e GJEDNJ-së të shprehë një pikëpamje nëse zgjedhjet e politikave të bëra nga Palët Kontraktuese që përcaktojnë kufizimet e qasjes në gjykatë janë të përshtatshme apo jo, por detyra e saj kufizohet në përcaktimin nëse zgjedhjet e tyre në këtë fushë prodhojnë pasoja që janë në përputhje me KEDNJ-në. Në mënyrë të ngjashme, roli i GJEDNJ-së nuk është të zgjidhë kontestet lidhur me interpretimin e ligjit të brendshëm që rregullon këtë qasje, por më tepër të konstatojë nëse efektet e një interpretimi, përkatësisht interpretimit të garancive procedurale nga një gjykatë vendore, janë në përputhje me parimet që ndërthrin KEDNJ në kontekst të parimeve që ndërlidhen me qasjen në gjykatë (shih, për shembull, [Platakou kundër Greqisë](#), nr. 38460/97, Aktgjykim i 5 shtatorit 2001, paragrafët 37-39; [Yagtzilar dhe të tjerët kundër Greqisë](#), nr. 41727/98, Aktgjykim i 10 korrikut 2002, paragrafi 25, dhe [Bulfracht Ltd kundër Kroacisë](#), nr. 53261/08, Aktgjykim i 21 qershorit 2011, paragrafi 35).



47. Në lidhje me këtë, duhet të theksohet se mënyra në të cilën zbatohet paragrafi 1 i nenit 6 të KEDNJ-së në gjykatat e apelit ose të kasacionit, varet nga karakteristikat e veçanta të procedurës në fjalë dhe duhet të merret parasysh tërësia e procedurave të zhvilluara në rendin juridik të brendshëm dhe roli i gjykatës së kasacionit në to; kriteret e pranueshmërisë së një ankese për çështjet ligjore mund të jenë më të rrepta se sa për një ankesë të zakonshme (shih, [Levages Prestations Services kundër Francës](#), cituar më lart, paragrafi 45; [Brualla Gómez de la Torre kundër Spanjës](#), cituar më lart, paragrafi 37; dhe [Kozlica kundër Kroacisë](#), nr.29182/03, Aktgjykim i 2 nëntorit 2006, paragrafi 32; shih gjithashtu [Shamoyan kundër Armenisë](#), nr. 18499/08, Aktgjykim i 7 korrikut 2015, paragrafi 29).
48. GJEDNJ ka pranuar më tej se aplikimi i një pragu ligjor *ratione valoris* për ankesat në gjykatën supreme dhe/ose të larta, është një kërkesë procedurale legjitime dhe e arsyeshme duke pasur parasysh thelbin e rolit të gjykatave të tilla, për t'u marrë vetëm me çështje të rëndësishme të nevojshme (shih, [Brualla Gómez de la Torre kundër Spanjës](#), cituar më lart, paragrafi 36; [Kozlica kundër Kroacisë](#), cituar më lart, paragrafi 33; [Bulfracht LTD kundër Kroacisë](#), cituar më lart, paragrafi 34, [Dobrić kundër Serbisë](#), nr. 2611/07 dhe 15276/07, Aktgjykim i 21 qershorit 2011, paragrafi 54; dhe [Jovanović kundër Serbisë](#), nr. 32299/08, Aktgjykim i 2 tetorit 2012, paragrafi 48).
49. Për më tepër, kur përballet me çështjet nëse procedurat në gjykatat e apelit ose të kasacionit ishin në përputhje me kërkesat e paragrafit 1 të nenit 6 të KEDNJ-së, GJEDNJ ka pasur parasysh shkallën në të cilën çështja është shqyrtuar në gjykatat më të ulëta, përfshirë (jo)ekzistenca e çështjeve që lidhen me drejtësinë e procedurave të zhvilluara pranë gjykatave më të ulëta dhe natyra e rolit të gjykatës në fjalë (shih, për konsideratat përkatëse rastet e GJEDNJ-së, [Levages Prestations Services kundër Francës](#), cituar më lart, paragrafët 45-49; [Brualla Gómez de la Torre kundër Spanjës](#), cituar më lart, paragrafët 37-39; [Sotiris dhe Nikos Koutras ATTEE kundër Greqisë](#), nr. 39442/98, Aktgjykim i 16 nëntorit 2000, paragrafi 22; dhe [Nakov kundër ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë \(vend. \)](#), nr. 68286/01, Aktgjykim i 24 tetorit 2002).
50. Gjithashtu, në lidhje me zbatimin e kufizimeve ligjore *ratione valoris* për qasje në gjykatat e larta, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së sic është shtjelluar më sipër, në vlerësimin nëse këto kufizime ligjore janë interpretuar në mënyrë tejet formaliste dhe rrjedhimisht joproportionale me të drejtën për qasje në gjykatë, Gjykata, duhet në shkallë të ndryshme të marrë parasysh disa faktorë të mëtejshëm, përkatësisht (i) parashikueshmërinë e kufizimit; (ii) nëse është parashtruesi i kërkesës ose shteti i paditur ai i cili duhet të bartë pasojat negative të gabimeve të bëra gjatë procedurës që çuan në mohimin e qasjes së parashtrueseve të kërkesës në gjykatën supreme; dhe (iii) nëse mund të thuhet se kufizimet në fjalë përfshijnë “*formalizëm të tepruar*” (shih, në veçanti, [Garzičić kundër Malit të Zi](#), nr. 17931/07, Aktgjykim i 21 shtatorit 2010, paragrafët 30-32; [Dobrić kundër Serbisë](#), cituar më lart, paragrafët 49-51; [Jovanović kundër Serbisë](#), cituar më lart, paragrafët 46-51; [Egić kundër Kroacisë](#), nr. 32806/09, Aktgjykim i 5 qershorit 2014, paragrafët 46-49 dhe 57; [Sociedad Anónima del Ucieza kundër Spanjës](#), nr.38963/08, Aktgjykim i 4 nëntorit 2014, paragrafët 33-35, dhe [Hasan Tunç dhe të tjerët kundër Turqisë](#), nr. 19074/05, Aktgjykim i 31 janarit 2017, paragrafët 30-34.). Secili prej këtyre kriterëve do të shpjegohet më në detaje më poshtë bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së.
51. Në vjëm, dhe për aq sa është relevante në rrethanat e rastit konkret, Gjykata do të paraqes parimet e zhvilluar nga GJEDNJ, ndërlidhur me tri kriteret e lartcekura.
- (i) *parashikueshmëria e kufizimit*

52. Për sa i përket kriterit të parë nga kriteret e lartcekura, në një sërë rastesh GJEDNJ i ka kushtuar rëndësi të veçantë nëse procedura që do të ndiqet për një ankesë për çështje ligjore mund të konsiderohet e parashikueshme nga këndvështrimi i palës ndërgjyqëse. Kjo ka për qëllim të vërtetojë nëse sanksioni për mosndjekjen e kësaj procedure nuk ka shkelur parimin e proporcionalitetit (shih, për shembull, [Mohr kundër Luksemburgut](#), nr. 29236/95, Vendim i 20 prillit 1999; [Lanschützer GmbH kundër Austrisë](#), nr. 17402/08, Vendim i 18 marsit 2014 paragrafi 33 dhe [Henrioud kundër Francës](#), nr. 21444/11, Aktgjykim i 5 nëntorit 2015, paragrafët 60-66).
53. Një praktikë koherente gjyqësore e brendshme dhe një zbatim i qëndrueshëm i kësaj praktike normalisht do të plotësojë kriterin e parashikueshmërisë në lidhje me një kufizim të qasjes në gjykatën e lartë (shih, për shembull, rastin e GJEDNJ-së, [Levages Prestations Services kundër Francës](#), cituar më lart, paragrafi 42; [Brualla Gómez de la Torre kundër Spanjës](#), cituar më lart, paragrafi 32; [Lanschützer GmbH kundër Austrisë](#), cituar më lart, paragrafi 34 dhe, nga ana tjetër, [Dumitru Gheorghe kundër Rumanisë](#), nr.33883/06, Aktgjykim i 12 prillit 2016, paragrafët 32-34).
54. E njëjta konsideratë ka udhëhequr qasjen e GJEDNJ-së në rastet në lidhje me kufizimet *ratione valoris* për qasje në gjykatat e larta (shih, [Jovanović kundër Serbisë](#), cituar më lart, paragrafi 48, dhe [Egić kundër Kroacisë](#), cituar më lart, paragrafët 49 dhe 57). GJEDNJ gjithashtu në praktikën e saj merr parasysh qasjen e parashtruesit të kërkesës në praktikën përkatëse dhe nëse ai ose ajo përfaqësohej nga një avokat i kualifikuar (shih, [Levages Prestations Services kundër Francës](#), cituar më lart, paragrafi 42, dhe [Henrioud kundër Francës](#), cituar më lart, paragrafi 61).
- (ii) *bartja e pasojave negative si rezultat i gabimeve të bëra gjatë procedurës – raporti në mes individit dhe shtetit*
55. Për sa i përket kriterit të dytë, GJEDNJ jo rrallë herë ka përcaktuar çështjen e proporcionalitetit duke identifikuar gabimet procedurale që kanë ndodhur gjatë procedurës të cilat përfundimisht e kanë penguar parashtruesin e kërkesës të ketë qasje në gjykatë dhe duke vendosur nëse parashtruesi është detyruar të mbajë një barrë të tepruar në lidhje me gabimet e tilla. Kur gabimi procedural në fjalë ka ndodhur vetëm në njërën anë, atë të parashtruesit të kërkesës ose të autoriteteve përkatëse, dhe kryesisht gjykatat GJEDNJ, në parim, vendosjen e barrës e ka vendosur mbi individin/autoritetin që ka bërë gabimin përkatës (shih, për shembull rastet e GJEDNJ-së, [Laskowska kundër Polonisë](#), nr. 77765/01, Aktgjykim i 13 marsit 2007, paragrafët 60-61; [Jovanović kundër Serbisë](#), cituar më lart, paragrafi 46 in fine; [Šimecki kundër Kroacisë](#), nr. 15253/10, Aktgjykim i 30 prillit 2014, paragrafët 46-47, [Egić kundër Kroacisë](#), cituar më lart, paragrafi 57, dhe [Sefer Yilmaz dhe Meryem Yilmaz kundër Turqisë](#), nr. 611/12, Aktgjykim i 17 nëntorit 2015, paragrafët 72-73).
56. Megjithatë, më problematike janë situatat kur gabimet procedurale kanë ndodhur si nga ana e parashtruesit të kërkesës, ashtu edhe nga ana e autoriteteve përkatëse, veçanërisht gjykata(t). Në raste të tilla nuk ka një rregull të qartë në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së në lidhje me çështjen se kujt duhet t'i bie barra; atëherë zgjidhja do të varej nga të gjitha rrethanat e rastit shikuar në tërësinë e tij. Thënë kështu, disa kritere udhëzuese mund të dallohen nga praktika gjyqësore e GJEDNJ-së si në vijim.
57. Së pari, duhet të përcaktohet nëse parashtruesi i kërkesës ka qenë i përfaqësuar gjatë procedurës dhe nëse parashtruesi dhe/ose përfaqësuesi i tij/saj ligjor kanë shfaqur



zëllin e duhur në ndjekjen veprimeve përkatëse procedurale. Në të vërtetë, të drejtat procedurale zakonisht do të shkojnë paralelisht me detyrimet procedurale. GJEDNJ gjithashtu thekson se palëve ndërgjyqëse u kërkohet të tregojnë kujdes në respektimin e hapave procedural në lidhje me rastin e tyre (shih, rastet e GJEDNJ-së, [Bakowska kundër Polonisë](#), nr. 33539/02, Aktgjykim i 12 janarit 2010, paragrafi 54; shih gjithashtu, *mutatis mutandis*, rastin [Unión Alimentaria Sanders S.A. kundër Spanjës](#), nr.11681/85, Aktgjykim i 7 korrikut 1989, paragrafi 35). Për më tepër, GJEDNJ ka vënë theksin në çështjen nëse përfaqësimi ligjor ishte në dispozicion për parashtruesit e kërkesës (shih, për shembull, rastet e GJEDNJ-së, [Levages Prestations Services kundër Francës](#), cituar më lart, paragrafi 48, dhe [Lorger kundër Sllovenisë](#) nr. 54213/12, Vendim i 26 janarit 2016, paragrafi 22).

58. Së dyti, GJEDNJ merr parasysh edhe nëse gabimet mund të ishin shmangur që në fillim (shih, për shembull, rastin e GJEDNJ-së, [Edificaciones March Gallego S.A. kundër Spanjës](#), Aktgjykim i 19 shkurtit 1998, paragrafi 35).
59. Së treti, GJEDNJ vlerëson nëse gabimet kryesisht ose objektivisht i atribuohen parashtruesit të kërkesës ose autoriteteve përkatëse, veçanërisht gjykatës(ve). Në veçanti, një kufizim i qasjes në gjykatë do të ishte joproporcional kur papranueshmëria e një mjeti juridik është rezultat i atribuimit të një gabimi një parashtruesi të kërkesës për të cilin ai ose ajo nuk është objektivisht përgjegjës (shih [Examiliotis kundër Greqisë \(nr. 2\)](#), nr. 28340/02, Aktgjykim i 4 majit 2006, paragrafi 28; shih gjithashtu [Platakou kundër Greqisë](#), cituar më lart, paragrafët 39 dhe 49; [Sotiris dhe Nikos Koutras ATTEE kundër Greqisë](#), cituar më sipër, paragrafi 21; dhe [Freitag kundër Gjermanisë](#), nr. 71440/01, Aktgjykim i 19 korrikut 2007, paragrafët 39-42).

*(iii) formalizmi i tepruar në interpretim dhe zbatim të ligjit*

60. Për sa i përket kriterit të tretë, GJEDNJ thekson se respektimi i rregullave të formalizuara të procedurës civile, përmes të cilave palët sigurojnë përcaktimin e një kontesti civil, është i vlefshëm dhe i rëndësishëm pasi është në gjendje të kufizojë diskrecionin, të sigurojë barazinë e armëve, parandalimin e arbitraritetit, sigurimin e zgjidhjes efektive të një kontesti dhe gjykimin brenda një afati të arsyeshëm dhe ofrimin e sigurisë juridike dhe respektimin e gjykatës.
61. Megjithatë, në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së është përcaktuar se “*formalizmi i tepruar*” mund të bie ndesh me kërkesën për sigurimin e një të drejte praktike dhe efektive për qasje në gjykatë sipas paragrafit 1 të nenit 6 të KEDNJ-së (shih, paragrafin 77 më lart). Kjo zakonisht ndodh në rastet e një konstruksioni veçanërisht të rreptë të një rregulli procedural, që parandalon shqyrtimin në merita të veprimit të parashtruesit të kërkesës, me rrezikun shoqërues që do të cenohej e drejta e tij/saj në mbrojtjen efektive të gjykatave (shih, rastet e GJEDNJ-së, [Bëlesh dhe të tjerët kundër Republikës Çeke](#), nr. 47273/99, Aktgjykim i 12 nëntorit 2002, paragrafët 50-51 dhe 69, dhe [Walchli kundër Francës](#), nr. 35787/03, Aktgjykim i 26 korrikut 2007, paragrafi 29).
62. Një vlerësim i një ankese për formalizëm të tepruar në vendimet e gjykatave të brendshme zakonisht do të jetë rezultat i një shqyrtimi të rastit të marrë në tërësi (shih [Bëlesh dhe të tjerët kundër Republikës Çeke](#), cituar më lart, paragrafi 69), duke pasur parasysh rrethanat e veçanta të atij rasti (shih, për shembull, rastet e GJEDNJ-së, [Stagno kundër Belgjikës](#), nr. 1062/07, Aktgjykim i 7 korrikut 2009, paragrafët 33-35, dhe [Fatma Nur Erten dhe Adnan Erten kundër Turqisë](#), nr. 14674/11, Aktgjykim i 25 nëntorit 2014, paragrafët 29-32.). Në bërjen e këtij vlerësimi, Gjykata shpesh ka

theksuar çështjet e “sigurisë juridike” dhe “administrimit të duhur të drejtësisë” si dy elemente qendrore për të bërë dallimin midis një formalizmi të tepruar dhe një zbatimi të pranueshëm të formaliteteve procedurale. Në veçanti, ajo ka konstatuar se e drejta e qasjes në gjykatë cenohet kur rregullat pushojnë së shërbyeri qëllimeve të sigurisë juridike dhe administrimit të duhur të drejtësisë dhe formojnë një lloj pengese që e pengon palën ndërgjyqëse që çështja e tij/saj të vendoset në merita nga gjykata kompetente (shih, për shembull, [Kart kundër Turqisë \[DHM\]](#), nr. 8917/05, Aktgjykim i 3 dhjetorit 2009, paragrafi 79 (ekstrakte); shih gjithashtu [Efstathiou dhe të tjerët kundër Greqisë, nr. 36998/02](#), Aktgjykim i 27 korrikut 2006 paragrafi 24, dhe [Eşim kundër Turqisë](#), nr. 59601/09, Aktgjykim i 17 shtatorit 2013, paragrafi 21).

63. Në praktikën gjyqësore pasuese të GJEDNJ-së, mbështetja në elementët e lartpërmendur është ndjekur në mënyrë të vazhdueshme në përcaktimin nëse ndërtimi i një rregulli procedural ka kufizuar në mënyrë të pajustificueshme të drejtën e një parashtruesi të kërkesës për qasje në gjykatë (shih, shembujt e rasteve të GJEDNJ-së, ku u konstatuan shkelje: [Nowiński kundër Polonisë](#), nr. 25924/06, Aktgjykim i 20 tetorit 2009 paragrafi 34; [Omerović kundër Kroacisë \(nr. 2\)](#), nr. 22980/09, Aktgjykim i 5 dhjetorit 2013, paragrafi 45; [Maširević kundër Serbisë](#), nr. 30671/08, Aktgjykim i 11 shkurtit 2014; [Cornea kundër Republikës së Moldavisë](#), nr. 22735/07, Aktgjykim i 22 korrikut 2014, paragrafi 24; dhe [Louli Georgopoulou kundër Greqisë](#), nr. 22756/09, Aktgjykim i 16 marsit 2017 paragrafi 48; dhe shembujt ku u konstatua se kufizimi i qasjes në gjykatë nuk kishte qenë joproporcional: [Wells kundër Mbretërisë së Bashkuar](#), nr. /37794/05, Vendim i 16 janarit 2007, dhe [Dunn kundër Mbretërisë së Bashkuar](#), nr. 62793/10, Vendim i 23 tetorit 2012, paragrafi 38).

### c) Zbatimi i parimeve të lartcekura në rrethanat e rastit konkret

64. Fillimisht, Gjykata rikujton se parashtrueset e kërkesës, që nga fillimi i procedurës gjyqësore kishin paraqitur një kërkesëpadi së bashku me prindërit e tyre, përmes një përfaqësuesi ligjor, për të kërkuar kompensim të dëmit material dhe jo material për vdekjen e vëllait të tyre në një aksident trafiku. Gjykata rithekson se Gjykata Themelore kishte akorduar shumën prej 8,000 € (tetë mijë euro) për secilën prej parashtrueseve të kërkesës në emër të dëmit jo material, ndërsa Gjykata e Apelit kishte ndryshuar Aktgjykimin e Gjykatës Themelore duke ulur shumën në fjalë në vlerën prej 5,000 € (pesë mijë euro) për secilën prej tyre. Në fund, Gjykata Supreme kishte hedhur poshtë si të palejuar revizionin e tyre.
65. Në vlerësimin nëse në rrethanat e rastit konkret, është cenuar e drejta e qasjes në drejtësi të parashtruesve të kërkesës, Gjykata në vijim, do të aplikojë parimet e shtjelluara si më sipër, duke vlerësuar fillimisht nëse (i) është kufizuar e drejta për qasje në drejtësi në rrethanat e parashtrueseve të kërkesës, dhe nëse ky është rasti, do të vazhdojë më vlerësimin (ii) nëse një kufizim i tillë ndjek një qëllim legjitim, dhe nëse ky është rasti, do të vlerësojë nëse një kufizim i tillë është (iii) proporcional me qëllimin e ndjekur. Në kontekst të kësaj të fundit, Gjykata do të aplikojë tri kriteret që burojnë nga praktika gjyqësore e GJEDNJ-së në kontekst të parimeve *ratione valoris*, përkatësisht (a) parashikueshmërinë e kufizimit; (b) bartja e pasojave negative si rezultat i gabimeve të bëra gjatë procedurës – raporti në mes individit dhe shtetit; dhe (c) formalizmin e tepruar në interpretim dhe zbatim të ligjit të aplikueshëm.

(i) Kufizimi i qasjes së parashtrueseve të kërkesës në Gjykatën Supreme

66. Gjykata fillimisht vëren se në sistemin juridik të Republikës së Kosovës, qasja në çështjet civile në nivel të Gjykatës Supreme, në parim, sigurohet përmes revizionit, i cili

sipas LPK-së kategorizohet si mjet i “*jashtëzakonshëm*” i goditjes. Sipas paragrafit 1 të nenit 214 (pa titull) të LPK-së, ky mjet juridik paraqitet për arsyet në vijim: (i) për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 188 i këtij ligji e cila është bërë në procedurën e gjykatës së shkallës së dytë; (ii) për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale; (iii) për shkak të tejkalimit të kërkesëpadisë, po që se kjo parregullsi është bërë në procedurën e zhvilluar në gjykatën e shkallës së dytë, ndërsa sipas paragrafit 2 të po këtij neni, revizioni nuk mund të paraqitet për shkak të konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike.

67. Gjykata po ashtu i referohet edhe kriterëve shtesë, e që janë parakusht për të paraqitur revizionin, të përcaktuara, ndër të tjera, në paragrafin 2 të nenit 211 të LPK-së, i cili parasheh se: “*211.2 Revizioni nuk lejohet në kontestet pasurore-juridike në të cilat kërkesëpadija ka të bëjë me kërkesat në të holla, me dorëzimin e sendit, ose me përmbushjen e ndonjë premtimi tjetër, po që se vlera e objektit të kontestit në pjesën e goditur të aktgjykimit nuk i kalon 3.000 €*”, si dhe paragrafin 3 të këtij neni, i cili përcakton se: “*211.3 Revizioni nuk lejohet në kontestet pasurore-juridike në të cilat kërkesëpadija nuk ka të bëjë me kërkesat në para, me dorëzimin e sendit apo me përmbushjen e ndonjë premtimi tjetër, po që se vlera e objektit të kontestit e treguar në padinë e paditësit nuk e kalon shumën prej 3.000 Euro.*” Gjykata vë në pah edhe kriterin e përcaktuar në nenin 508 (pa titull) të LPK-së që parasheh se revizioni në kontestet tregtare nuk lejohet në qoftë se vlera e objektit të kontestit në pjesën e goditur të aktgjykimit të formës së prerë nuk i kalon 10.000 € (dhjetë mijë euro). Sipas përcaktimeve të LPK-së, Gjykata Supreme mund të (i) aprovojë revizionin dhe të shfuqizojë/anulojë (pjesërisht/në tërësi) aktgjykimet e gjykatave më të ulëta, si dhe ta kthejë rastin në rivendosje ose, në disa raste, (ii) ta aprovojë revizionin dhe ta ndryshojë aktgjykimin e kontestuar. Në çdo rast, Gjykata Supreme është e autorizuar ta deklarojë të papranueshme revizionin që nuk plotëson kërkesat përkatëse ligjore.
68. Në rastin konkret, parashtrueset e kërkesës parashtruan revizion duke konsideruar se vlera e kërkesës së tyre kishte arritur pragun përkatës ligjor *ratione valoris* prej 3,000 € (tre mijë euro). Megjithatë, Gjykata Supreme e deklaroi revizionin e tyre të papranueshëm *ratione valoris*. Ajo konstatoi se vlera e objektit të kontestit në pjesën e goditur të aktgjykimit nuk e kalon shumën prej 3,000 € (tre mijë euro) për secilën prej tyre, të përcaktuar në paragrafin 2 të nenit 211 të LPK-së, dhe se duke u bazuar në nenin 268 (pa titull) të LPK-së, ato i konsideroi bashkëndërgjyqëse të thjeshta, ku pozita procedurale e një bashkëndërgjyqësi nuk varet nga pozita procedurale e bashkëndërgjyqësve tjerë dhe rrjedhimisht vlera e kontestit duhet të vlerësohet për secilën palë veç e veç.
69. Nisur nga sa më sipër, Gjykata thekson se natyra e kufizimit në fjalë, që rrjedh nga ligji përkatës i procedurës kontestimore, në vetvete nuk duket të jetë rezultat i rregullave procedurale jofleksibile. Ligji parashikon mundësinë e paraqitjes së revizionit nëse vlera e objektit të kontestit në pjesën e goditur të aktgjykimit nuk i kalon 3.000 (tre mijë euro) sipas paragrafit 2 të nenit 211 të LPK-së, i cili mund t'i siguronte qasje parashtrueseve në Gjykatën Supreme.
70. Duke pasur parasysh këto konsiderata, Gjykata do të shqyrtojë nëse kufizimi në fjalë, përkatësisht ai i përcaktuar në paragrafin 2 të nenit 211 të LPK-së, është i justifikuar, përkatësisht nëse ndjek një qëllim legjitim.

*(ii) qëllimi legjitim lidhur me kufizimin e vlerës së kontestit në procedurën e revizionit*

71. Gjykata vëren se kufizimi i kontestuar për qasje në Gjykatën Supreme bie brenda qëllimit legjitim të njohur përgjithësisht të pragut ligjor *ratione valoris* për mjetet

juridike në Gjykatën Supreme, për të siguruar që Gjykata Supreme, duke pasur parasysh thelbin e rolit të saj, merret vetëm me çështje të rëndësishme të nevojshme (shih, rastet e GJEDNJ-së, *Brualla Gómez de la Torre kundër Spanjës*, cituar më lart, paragrafi 36; *Kozlica kundër Kroacisë*, cituar më lart, paragrafi 33; *Bulfracht LTD kundër Kroacisë*, cituar më lart, paragrafi 34; *Dobrić kundër Serbisë*, cituar më lart, paragrafi 54; dhe *Jovanović kundër Serbisë*, cituar më lart, paragrafi 48). Pra, Gjykata vëren se qëllimi i ligjvënësimit ka të bëjë dallimin në mes të kontesteve në vlera të vogla dhe atyre të mëdha, në mënyrë që vetëm këtyre të fundit t'ua mundësojë për qasjen në gjykatat më larta.

72. Për më tepër, sipas paragrafit 2 të nenit 103 [Organizimi dhe Jurisdiksioni i Gjykatave] të Kushtetutës, Gjykata Supreme e Kosovës është autoriteti më i lartë gjyqësor, ndërsa sipas paragrafit 5 të nenit 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] të Kushtetutës, e drejta e përdorimit të mjeteve të jashtëzakonshme juridike, rregullohet me ligj. Duke marrë parasysh këtë, Gjykata thekson që dispozita ligjore e cila përcakton pragun ligjor *ratione valoris* para Gjykatës Supreme ndjek një qëllim legjitim, përkatësisht respektimin e sundimit të ligjit dhe administrimit e duhur të drejtësisë. Prandaj, duke vënë theks në faktin që kufizimet ligjore *ratione valoris* për të pasur qasje në Gjykatën Supreme në kontekst të mjetit juridik të revizionit, ndjekin një qëllim legjitim. Megjithatë në rrethanat e rastit konkret, duhet të vlerësohet nëse aplikimi i kufizimit ishte proporcional me qëllimin e ndjekur dhe testi i proporcionalitetit vlerësohet, duke u bazuar në kriteret e ndërhuara nga praktika gjyqësore e GJEDNJ-së e shtjelluar si më sipër.

(iii) *proporcionaliteti i kufizimit*

73. Siç është thënë më lart, Gjykata thekson që lejueshmëria e kufizimeve *ratione valoris* për qasje në Gjykatën Supreme ndjek një qëllim legjitim dhe bazuar në praktikën e GJEDNJ-së, është në pajtim me kufirin e vlerësimit të autoriteteve vendase në rregullimin e këtyre modaliteteve ligjore (shih, rastet e GJEDNJ-së, *Brualla Gómez de la Torre kundër Spanjës*, cituar më lart, paragrafi 36; *Kozlica kundër Kroacisë*, cituar më lart, paragrafi 33; *Bulfracht LTD kundër Kroacisë*, cituar më lart, paragrafi 34; *Dobrić kundër Serbisë*, cituar më lart, paragrafi 54; dhe *Jovanović kundër Serbisë*, cituar më lart, paragrafi 48). Përpara se të vlerësojë proporcionalitetin e kufizimit në fjalë, Gjykata e sheh gjithsesi të rëndësishme të identifikojë shtrirjen e këtij kufiri në lidhje me mënyrën e zbatimit të rregullave në lidhje me pragun *ratione valoris* në rastin në fjalë. Në bërjen e këtij vlerësimi, duke u bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, Gjykata do të ketë parasysh shkallën në të cilën rasti është shqyrtuar para gjykatave më të ulëta; (mos)ekzistimin e çështjeve që lidhen me drejtësinë e procedurave të zhvilluara para gjykatave më të ulëta, dhe natyrën e rolit të Gjykatës Supreme.
74. Në lidhje me çështjen e parë të përmendur më sipër, Gjykata vëren se rasti i parashtrueseve të kërkesës u dëgjua nga dy nivele gjyqësore (Gjykata Themelore dhe Gjykata e Apelit) që ushtrojnë juridiksion të plotë në këtë çështje. Më tej, në lidhje me çështjen e dytë të përmendur më sipër, Gjykata vëren se, në këtë rast nuk lind asnjë çështje e dukshme e mungesës së drejtësisë para gjykatave më të ulëta. Për sa i përket çështjes së tretë të përmendur më lart, Gjykata vëren se roli i Gjykatës Supreme ka qenë i kufizuar në shqyrtimin e pranueshmërisë së rastit, respektivisht vlerësimit të kriterëve ligjore për qasje në gjykatën më të lartë (shih, *Brualla Gómez de la Torre kundër Spanjës*, cituar më lart, paragrafi 37). Gjykata bazuar në praktikën e GJEDNJ-së, vlerëson se në rrethanat të tilla, Gjykata Supreme gëzon një hapësirë të gjerë vlerësimi në lidhje me mënyrën e zbatimit të kufizimeve përkatëse *ratione valoris* në rastin konkret.

75. Megjithatë, kjo nuk do të thotë se Gjykata Supreme gëzon diskrecion të pakufizuar në këtë drejtim. Gjatë shqyrtimit nëse ky kufi është tejkaluar, Gjykata duhet të jetë veçanërisht e vëmendshme ndaj tri kriterëve të theksuara në paragrafin 50 më lart, përkatësisht (i) parashikueshmërisë e kufizimit, përkatësisht procedurës që duhet ndjekur për parashtrimin e revizionit; (ii) çështjes se kush duhet të bartë pasojat negative të gabimeve të bëra gjatë procedurës, dhe (iii) çështjes nëse formalizmi i tepruar në interpretimin dhe zbatimin e dispozitiva të ligjit të aplikueshëm.

*(a) parashikueshmëria e kufizimit*

76. Për sa i përket parashikueshmërisë së kufizimit, përkatësisht procedurës që do të ndiqet në parashtrimin e mjetit juridik për qasje në gjykatat më të larta, Gjykata rikujton parimet e GJEDNJ-së, të cilat theksojnë se një praktikë koherente gjyqësore e brendshme dhe një zbatim i qëndrueshëm i kësaj praktike normalisht do të plotësojë kriterin e parashikueshmërisë në lidhje me një kufizim të qasjes në gjykatën e lartë (shih, rastet e GJEDNJ-së *Jovanović kundër Serbisë*, cituar më lart, paragrafi 48, dhe *Egić kundër Kroacisë*, cituar më lart, paragrafët 49 dhe 57).
77. Në këtë kontekst, Gjykata duhet theksuar fillimisht se ligji përkatës që rregullon procedurën civile, përkatësisht Ligji Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore, i cili përmban dispozitat kufizuese për paraqitjen e revizionit, është publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës më 20 shtator 2008, me nr. 38/2008 dhe është i qasshëm për publikun. Po ashtu, Gjykata nënvizon se praktika gjyqësore e Gjykatës Supreme është konsistente dhe e qartë deri në masën që shumat të cilat nuk kalojnë vlerën 3,000 € (tre mijë euro) të objektit të kontestit në pjesën e goditur të aktgjykimit, në kundërshtim me kërkesat procedurale të paragrafit 2 të nenit 211 të LPK-së, nuk mund të çojnë në pranueshmërinë e revizionit.
78. Për më tepër, sipas paragrafit 2 të nenit 211 të LPK-së, në rast se vlera e objektit të kontestit në pjesën e goditur të aktgjykimit është fiks në shumën 3,000 € (tre mijë euro), revizioni po ashtu nuk është i lejuar. Në rastin konkret, janë 4 (katër) parashtrues të kërkesës, të cilave Gjykata e Apelit iu kishte ulur vlerën e shumës së kompensuar në emër të dëmit jo material për vdekjen e vëllait të tyre nga 8,000 € (tetë mijë euro) në 5,000 € (pesë mijë euro) për secilën prej tyre, çka rezultoi se secila veç e veç, vlerën e objektit të kontestit në pjesën e goditur të aktgjykimit e kanë në shumën prej fiks 3,000 € (tre mijë euro). Megjithatë, parashtrueset e kërkesës kanë parashtruar një revizion të përbashkët për kërkesat e tyre në emër të dëmshpërblimit jo material, dhe sipas pretendimeve të të cilave para Gjykatës Supreme, vlera e kontestit të tyre është në shumë prej 12,000 € (dymbëdhjetë mijë euro), shumë e cila e kalon vlerën prej 3,000 € (tre mijë euro).
79. Thënë këtë, dhe marrë parasysh dispozitat e LPK-së që ndërlidhen me kufizimet në paraqitjen e revizionit si dhe praktikën gjyqësore të Gjykatës Supreme në interpretimin e tyre, Gjykata vlerëson se procedura që për paraqitjen e revizionit është e rregulluar në një mënyrë koherente dhe të parashikueshme në ligjin e aplikueshëm, dhe rrjedhimisht, kufizimi përkatës është i parashikueshëm.

*(b) bartja e pasojave negative të gabimeve të bëra gjatë procedurës*

80. Për sa i përket kriterit të dytë, Gjykata rithekson se praktika e GJEDNJ-së, kërkon që duhet të përcaktohet nëse parashtruesi ka qenë i përfaqësuar gjatë procedurave dhe se a kishte treguar zell të nevojshëm në ndërmarrjen e veprimeve përkatëse procedurale,

duke vijuar me përcaktimin e asaj nëse gabimet ishin të mundshme të shmangeshin që në fillim dhe nëse gabimet mundeshin që kryesisht t'i atribuohen parashtruesit apo autoriteteve kompetente (shih, rastet e GJEDNJ-së, *Bakowska kundër Polonisë*, cituar më lart, paragrafi 54, *Edificaciones March Gallego S.A. kundër Spanjës*, cituar më lart, paragrafi 35, *Examiliotis kundër Greqisë (nr. 2)*, cituar më lart, paragrafi 28). Pra, në rastin konkret, Gjykata duhet vlerësuar nëse parashtrueset e kërkesës apo edhe gjykatat e shkallës së parë dhe të dytë kanë bërë gabime procedurale në lidhje me përcaktimin e vlerës së objektit të kontestit gjatë procedurës, dhe në rast se ka të tilla, kujt i atribuohen.

81. Në veçanti, Gjykata vëren se parashtrueset e kërkesës kishin parashtruar vetëm një padi të përbashkët në Gjykatën Themelore kundër kompanisë së sigurimeve, së bashku me prindërit e tyre, me kërkesën për kompensim të dëmit material dhe jo material me rastin e vdekjes së vëllait të tyre në aksident trafik. Pas aprovimit të pjesërisht të kërkesëpadisë së tyre nga Gjykata Themelore, si pasojë e ankesës së kompanisë së sigurimeve, Gjykata e Apelit uli shumat monetare, të akorduara për secilën prej parashtrueseve të kërkesës.
82. Gjykata po ashtu vë në dukje se parashtrueset e kërkesës që nga fillimi i procedurës gjyqësore ishin të përfaqësuar nga i njëjti përfaqësues ligjor, i cili i kishte këshilluar në përdorimin e mjeteve juridike sipas radhës, përfshirë paraqitjen e revizionit para Gjykatës Supreme dhe se kërkesëpadiat, në parim, kishte të bënte me të njëjtat rrethana faktike dhe juridike për të gjitha parashtrueset e kërkesës. Kjo sepse, as nga përmbajtja e aktgjykimit të Gjykatës Themelore dhe as atij të Gjykatës së Apelit, nuk rezulton se kërkesat e parashtrueseve të kërkesës janë trajtuar si të veçanta, por të dyja aktgjykimet përmbajnë të njëjtin arsyetim përkitazi me akordimin e shumave të njëjta për të gjitha parashtrueset, në emër të kompensimit të dëmit jo material, ndonëse shumat në dispozitivin e aktgjyqimeve janë vendosur veçantë për secilën.
83. Thënë këtë, Gjykata në pajtim me parimet dhe kriteret e lartcekura të vendosura përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, vlerëson se parashtrueset e kërkesës kanë ndjekur procedurën e mjeteve juridike sipas radhës dhe këshillës së përfaqësuesit të tyre ligjor, dhe në këtë kontekst, nuk rezulton se të njëjtat nuk kishin treguar kujdesin e nevojshëm kur kanë parashtruar mjetet juridike në fjalë. Andaj, Gjykata konstaton se konkludimi i Gjykatës Supreme se revizioni i tyre është i palejuar ashtu siç përcaktohet me paragrafin 2 të nenit 211 të LPK-së, nuk mund t'i atribuohet veprimeve dhe/ose dështimeve procedurale të parashtrueseve të kërkesës.

(c) *“formalizmi i tepruar” në interpretim dhe zbatim të ligjit të aplikueshëm*

84. Në lidhje me kriterin e “formalizmit të tepruar” në interpretimin dhe zbatimin e ligjit të aplikueshëm, Gjykata përsërit qëndrimet e GJEDNJ-së në praktikën e saj gjyqësore, ku ka theksuar se *“formalizmi i tepruar”* nga ana e gjykatave mund të jetë në kundërshtim me të drejtën për qasje në gjykatë. Sipas GJEDNJ-së, kjo zakonisht ndodh në rastet që përfshijnë një ndërtim veçanërisht të rreptë të një rregulli procedural, që parandalon shqyrtimin e meritave të kërkesës së palës, me rrezikun që të cenohet e drejta e tij/saj për mbrojtjen efektive para gjykatave. Një vlerësim i një ankese me formalizëm të tepruar nga ana e gjykatave vendore zakonisht është rezultat i një shqyrtimi të një çështjeje në tërësi, duke pasur parasysh rrethanat e veçanta të asaj çështjeje (shih, rastet e GJEDNJ-së me shkelje, *Nowiński kundër Polonisë*, cituar më lart, paragrafët 31-32; *Omerović kundër Kroacisë (nr. 2)*, cituar më lart, paragrafi 39, *Maširević kundër Serbisë*, cituar më lart, paragrafi 46; *Cornea kundër Republikës së Moldavisë*, cituar më lart, paragrafi 22).

85. Në rastin konkret, nuk ka asnjë arsye për të vënë në pikëpyetje edhe rregullimin përkatës procedural sipas paragrafit 2 të nenit 211 të LPK-së, në lidhje me pragun ligjor *ratione valores* përkitazi me shumën prej 3,000 € (tre mijë euro). Megjithatë, në kuptim të vlerësimit se si janë zbatuar kërkesat procedurale të ligjit, respektivisht, nëse Gjykata Supreme ka përdorur apo jo formalizëm të tepruar gjatë interpretimit të dispozitave përkatëse ligjore në fuqi e që ndërlidhen me lejueshmërinë e revizionit, Gjykata, së pari, i referohet pjesëve relevante të aktvendimit të kontestuar, dhe vëren se Gjykata Supreme konkluzionin për hedhje poshtë, si të palejuar, të kërkesës për revizion e kishte arsyetuar si në vijim:

*“[...] Ndërsa paditësit nuk kanë ushtruar ankesë kundër aktgjykimit të shkallës së parë, andaj në pjesën refuzuese aktgjykimi i shkallës së parë ka marrë formën e prerë në momentin e kalimit të afatit të ankesës, pasi pala e paditur në pjesën refuzuese nuk ka goditur aktgjykimin e shkallës së parë, ndërsa nga gjykata e shkallës së dytë aktgjykimi i shkallës së parë në pjesën refuzuese nuk është shqyrtuar, andaj në këtë pjesë nuk mund të goditet fare me revizion.*”

*Me dispozitën e nenit 211 paragrafi 2 i LPK-së, përcaktohet se: “revizioni nuk është i lejuar në kontestet pasurore-juridike, në të cilat kërkesëpadia ka të bëjë me kërkesat në të holla, dorëzimin e sendit ose me kryerjen e ndonjë veprimi, nëse vlera e objektit të kontestit në pjesën e goditur nuk kalon shumën 3000 €”, ndërsa me dispozitën e nenit 218, të LPK-së dhe nenin 11 të Ligjit Nr. 04/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore, me të cilin është riformuluar neni 218 i ligjit bazik, përcaktohet se: “1. Revizioni i paraqitur pas kohe, i palejueshëm apo jo i plotë, hedhet poshtë me aktvendim të Gjykatës së shkallës së parë pa mbajtur seancë gjyqësore. 2. Revizioni është i palejueshëm nëse: a) e ka paraqitur personi i cili nuk është i autorizuar për paraqitjen e revizionit; b) revizionin e ka paraqitur personi i cili e ka tërhequr revizionin; c) nëse personi i cili ka paraqitur revizionin nuk ka interes për paraqitjen e tij; d) është paraqitur revizioni kundër aktgjykimit kundër të cilit sipas ligjit nuk mund të paraqitet”.*

*Nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore, Gjykata Supreme e Kosovës erdhi në përfundim se revizioni nuk lejohet kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac. Nr. 3023/2020 të datës 07.04.2023, për arsye se dispozitat e cituara i referohen lejueshmërisë së revizionit e kushtëzuar me vlerën e kontestit e cila duhet të jetë mbi 3,000 (tre mijë) euro, për të qenë i lejuar revizioni, dhe situatës kur revizioni lejohet pavarësisht vlerës së kontestit sipas kriterit përjashtues për natyrën e çështjes kontestuese. Në këtë rast vlera e kontestit në pjesën e refuzuar nga gjykata e shkallës së dytë për paditësit për secilën kërkesë veç e veç të tyre është dhe atë: paditëses [R.C], motra e të ndjerit në shumën prej 3,000 €, paditëses [F.C], motra e të ndjerit në shumën prej 3,000 €, paditëses [L.C], motra e të ndjerit në shumën prej 3,000 €, paditëses [S.C.], motra e të ndjerit në shumën prej 3,000 €, e që nuk e kalon shumën prej 3,000 € për asnjërin prej paditësve. Në këtë çështje kemi të bëjmë me bashkëndërgjyqës të thjeshtë, ku pozita procedurale e një bashkëndërgjyqësi nuk varet nga pozita procedurale e bashkëndërgjyqësve tjerë. Në bazë të nenit 268 të LPK-së, çdo njeri nga këta është i pavarur në gjykim dhe se vlera e kontestit merret veç e veç për çdo njeri prej tyre [...]”.*

86. Nga leximi i normës ku është mbështetur Gjykata Supreme, respektivisht paragrafi 2 i nenit 211 i LPK-së, është e qartë se vlera e objektit të kontestit, në pjesën e goditur të Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, precizohet nga pala e dëmtuar, nëpërmjet ushtrimit të revizionit. Pra, është e drejtë diskrecionale e palës së dëmtuar të vendosë nëse dëshiron ta atakojë pjesërisht ose në tërësi aktgjykimin e shkallës së dytë, nëpërmjet



ushtrimit të revizionit në Gjykatën Supreme (shih, rastin e Gjykatës, [KI143/21](#), parashtrues *Avdyl Bajgora*, cituar më lart, paragrafi 71).

87. Gjykata në vazhdim i referohet dispozitivit të Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, i cili përcakton në pikën II të tij se: *“APROVOHET pjesërisht e themeltë ankesa e të paditurës Kompania e Sigurimeve "ELSIG" me seli në Prishtinë, NDRYSHOHET Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj - dega në Kaçanik, C.nr.237/18, i datës 13.12.2019 në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit sa i përket dëmit jomaterial për dhimbje shpirtërore për paditëset [R.C.], [F.C.], [L.C.] si dhe [S.C.] dhe në pikën II të dispozitivit të aktgjykimit dhe tani gjykohet si vijon: DETYROHET e paditura Kompania e Sigurimeve "ELSIG" me seli në Prishtinë, që për dëmin jomaterial për dhimbjet shpirtërore për shkak të vdekjes së anëtarit të familjes t'i paguajë shumat si në vijim: - Paditëses [R.C.], motra e të ndjerit shumën prej 5,000.00 euro; -Paditëses [F.C.], motra e të ndjerit shumën prej 5,000.00 euro; -Paditëses [L.C.], motra e të ndjerit shumën prej 5,000.00 euro dhe Paditëses [S.C.], motra e të ndjerit shumën prej 5,000.00 euro, të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8% që nga dita e marrjes së aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë 13.12.2019, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit e nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë [...]”.*
88. Në rastin konkret, qartazi vërehet se parashtrueset e kërkesës e kanë atakuar pjesërisht Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit përmes të cilit u ndryshua pjesërisht Aktgjykimi i Gjykatës Themelore, me të cilën fillimisht u aprovua kërkesëpadija e tyre për kompensim të dëmit jomaterial në vlerë prej 8,000 (tetë mijë euro) për secilën veç e veç, ndërsa pas procedurës së ankimit është ulur në shumën në vlerë prej 5,000 (pesë mijë euro). Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se parashtrueseve të kërkesës iu është refuzuar, diferenca e shumës në vlerë prej 3,000 € (tre mijë euro) për secilën veç e veç, dhe se në rastin konkret, ato këto shuma i kishin goditur me revizion.
89. Siç është shtjelluar më sipër, Gjykata e vlerëson legjitim kufizimin në paragrafin 2 të nenit 211 të LPK-së lidhur me vlerën prej 3,000 € (tre mijë euro) për të pasur mundësinë e paraqitjes së revizionit në Gjykatën Supreme. Për më tepër dhe siç është theksuar më sipër, Gjykata vlerëson që bazuar në ligjin e aplikueshëm por edhe praktikën gjyqësore të Gjykatës Supreme, është e qartë që vlera e objektit të kontestit që nuk tejkalon shumën prej € (tre mijë euro) euro nuk plotëson kushtet për të trajtuar revizionin e ushtruar në meritat. Thënë këtë, në rrethanat e rastit konkret, përfshirë bazuar në pretendimet e parashtruesve të kërkesës, është kontestuese nëse vlera e kontestit prej € (tre mijë euro) eurosh për secilën nga parashtrueset, duhet të jetë vlerësuar vec e vec nga Gjykata Supreme për qëllime të pranueshmërisë së revizionit, apo marrë parasysh rrethanat specifike të rastit, të jetë vlerësuar në tërësinë e tij, përkatësisht në vlerën prej 12,000 € (dymbëdhjetë mijë euro). Gjykata rikujton se Gjykata Supreme ka ardhur në konstatimin se vlera e kontestit nuk e kalon shumën prej 3,000 € (tre mijë euro) për asnjërën prej paditëseve, respektivisht, parashtrueset e kërkesës sepse të njëjtat i konsideroi si bashkëndërgjyqëse të thjeshta bazuar në nenin 268 të LPK-së, i cili përcakton që: *“Secili bashkëndërgjyqës në procesin kontestimor është palë në vete dhe kryerja apo moskryerja e veprimeve të tilla procedurale, as nuk i shkojnë në favor e as në dëm bashkëndërgjyqësve të tjerë”.*
90. Megjithatë, duke pasur parasysh pretendimin e parashtrueseve të kërkesës se ato ishin trajtuar si bashkëndërgjyqëse të thjeshta, pavarësisht se kishin paraqitur një kërkesëpadi, përkatësisht, ankesë dhe revizion të përbashkët nën rrethanat e njëjta faktike dhe juridike, Gjykata i referohet dispozitave ligjore të LPK-së, që rregullojnë parashtrimin e padisë në këto situata, respektivisht, nenit 32 (pa titull) të LPK-së, i cili përcakton se:



*“32.1 Në qoftë se një padi e ngritur kundër një të padituri përfshihen disa kërkesa që mbështetën në të njëjtën bazë faktike dhe juridike, atëherë vlera e objektit të kontestit caktohet sipas shumës së përgjithshme të vlerës së të gjitha kërkesave.*

*32.2 Në qoftë se kërkesat në padi rezultojnë nga baza të ndryshme, apo në qoftë se janë ngritur kundër disa të paditurve, vlera e objektit të kontestit caktohet sipas vlerës së secilës kërkesë veç e veç.”*

91. Tutje, Gjykata rikujton edhe përmbajtjen e paragrafit 1 të nenit 269 të LPK-së, i cili parasheh se: *“269.1 Në qoftë se sipas ligjit ose për shkak të natyrës së raportit juridik kontesti mund të zgjidhet vetëm në mënyrë të njëjtë ndaj të gjithë bashkëndërgjyqësve (bashkëndërgjyqësia unike), atëherë ata të gjithë konsiderohen si një palë ndërgjyqëse e vetme, kështu që në rastin kur ndonjëri nga bashkëndërgjyqësit nuk e kryen ndonjë veprim procedural, efekti i veprimeve procedurale të kryera nga bashkëndërgjyqësi tjetër shtrihet edhe në ata që nuk i kanë kryer veprimet e tilla.”*
92. Në këtë kontekst, Gjykata rikujton se parashtrueset e kërkesës, që nga fillimi i procedurës gjyqësore kishin paraqitur një kërkesëpadi përmes një përfaqësuesi ligjor, për të kërkuar kompensim të dëmit material dhe jo material për vdekjen e vëllait të tyre në një aksident trafiku. Për më tepër, Gjykata përsërit se Gjykata e Apelit në Aktgjykimin e saj kishte dhënë arsyetim të njëjtë për uljen e shumës së akorduar për kompensim të dëmit jomaterial për të gjitha parashtrueset e kërkesës, e cila shumë ishte e njëjtë për të gjitha, si vijon: *“[...] Gjykata e Apelit gjatë vlerësimit të pretendimeve ankimore të palës së paditur gjeti se qëndrojnë pjesërisht të themelta pretendimet lidhur me kompensimin e dëmit jo material për dhimbje shpirtërore sa i përket motrave të t'ndjerit [E.C.], për arsye se kjo Gjykatë gjen se shumat e aprovuara nga Gjykata e shkallës së parë janë shuma tejet të larta dhe nuk janë në përputhje me praktikën gjyqësore. Gjykata e Apelit vlerëson se shumat e caktuara sikurse në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, pra shuma prej 5,000.00 euro për secilën nga paditëset si motrat e të ndjerit është shumë adekuate dhe në përputhje me dhimbjet shpirtërore të përjetuara, e po ashtu në përputhje me praktikën gjyqësore. [...]”*
93. Thënë këtë, Gjykata vëren që, përderisa Gjykata Supreme, në Aktvendimin e saj, sqaroi refuzimin e revizionit mbi bazën e vlerës së objektit të kontestit për secilën nga parashtrueset veç e veç, e njëjta çështjen e bashkë-ndërgjyqësisë, dhe e cila ishte esenciale në përcaktimin e vlerës së përgjithshme të kontestit në rrethanat specifike të rastit, e trajtoi vetëm sipërfaqësisht, duke theksuar që *“në këtë çështje kemi të bëjmë me bashkëndërgjyqës të thjeshtë, ku pozita procedurale e një bashkëndërgjyqësi nuk varet nga pozita procedurale e bashkëndërgjyqësve tjerë. Në bazë të nenit 268 të LPK-së, çdo njeri nga këta është i pavarur në gjykim dhe se vlera e kontestit merret veç e veç për çdo njeri prej tyre”.*
94. Bazuar në si më sipër, Gjykata vëren që përderisa nuk është kontestuese që bazuar në nenin 211 të LPK-së, revizioni nuk lejohet në kontestet pasurore-juridike në të cilat kërkesëpadia ka të bëjë me kërkesat në të holla, me dorëzimin e sendit, ose me përmbushjen e ndonjë premtimi tjetër, po që se vlera e objektit të kontestit në pjesën e goditur të aktgjykimit nuk i kalon 3.000 Euro, në rrethanat e rastit konkret, çështja e bashkë-ndërgjyqësisë ishte vendimtare për përcaktimin e vlerës së përgjithshme të objektit të kontestit. Gjykata vëren që përderisa Gjykata Supreme, në Aktvendimin e saj, u referuara në nenin 268 të LPK-së për të kualifikuar pozicionin e secilës nga motrat parashtruese si bashkë-ndërgjyqëse të thjeshta me pasojën e vlerësimit të vlerës së objektit të kontestit për secilën veç e veç dhe rrjedhimisht pasojën e refuzimit të revizionit. Thënë këtë, dhe përkundër pretendimeve të palëve para saj, Gjykata Supreme, nuk u referua dhe as nuk sqaroi dispozitën e LPK-së, përkatësisht nenin 32 të

saj, dhe e cila, ndërlihet pikërisht me mënyrën e përcaktimit të vlerës së përgjithshme të objektit të kontestit, dhe e cila përcakton që (i) në qoftë se një padi e ngritur kundër një të padituri përfshihen disa kërkesa që mbështeten në të njëjtën bazë faktike dhe juridike, atëherë vlera e objektit të kontestit caktohet sipas shumës së përgjithshme të vlerës së të gjitha kërkesave; dhe (ii) në qoftë se kërkesat në padi rezultojnë nga baza të ndryshme, apo në qoftë se janë ngritur kundër disa të paditurve, vlera e objektit të kontestit caktohet sipas vlerës së secilës kërkesë veç e veç.

95. Gjykata përsërit se nuk është detyrë e saj të vlerësojë nëse gjykatat e rregullta kanë interpretuar dhe zbatuar drejtë rregullat përkatëse të së drejtës materiale dhe procedurale. Megjithatë, në rastet kur një pretendim ngrenë çështje kushtetuese, përkatësisht parregullsi të procesit gjyqësor, Gjykata është e detyruar të ndërhyjë dhe të riparojë shkeljet e shkaktuara nga gjykatat e rregullta, për t'i siguruar individit një gjykim të drejtë në pajtueshmëri me nenin 31 të Kushtetutës dhe paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ-së (shih, rastin e Gjykatës, [KI143/21](#), parashtrues *Avdyl Bajgora*, cituar më lart, paragrafi 78). Në këtë kontekst, Gjykata mund të bëjë vlerësimin e interpretimeve ligjore të gjykatave të rregullta përjashtimisht dhe atë vetëm nëse ato interpretime mund të kenë rezultuar në konkluzione arbitrare ose qartazi të paarsyeshme (shih, rastin e Gjykatës [KI75/17](#), parashtrues *X*, Aktgjykim i 30 janarit 2018, paragrafi 59).
96. Në rrethanat e rastit konkret, dhe në të cilat, interpretimi dhe arsytimi i qartë i dispozitave të LPK-së që ndërlihen me bashkë-ndërgjyqësinë dhe përcaktimin e vlerës së objektit të kontestit, ishte vendimtare për qasjen në drejtësi së palëve parashtrueseve të revizionit, Gjykata vlerëson, që ishte detyrë primare e Gjykatës Supreme, që dispozitat relevante të LPK-së të i shtjellojë dhe aplikojë në tërësinë e tyre dhe jo në mënyrë të izoluar. Më saktësisht, aplikimi i nenit 211 të LPK-së në ndërlihdje me nenin 268 të LPK-së, në anashkalim të plotë të nenit 32 të LPK-së, aplikimi dhe/ose arsytimi për mosaplikimin e të cilit ishte vendimtarë për palët parashtrueseve të revizionit, kualifikohet si “*formalizëm i tepruar*” në interpretimin dhe zbatimin e ligjit në kontekst të qasjes në drejtësi sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së.
97. Gjykata rithekson, që interpretimi dhe zbatimi i ligjit është në kompetencën e plotë të Gjykatës Supreme, dhe sipas shtjellimeve të dhëna më sipër, Gjykata nuk konteston aplikimin e dispozitave të LPK-së në kontekst të parimeve *ratione valoris* nga ana e Gjykatës Supreme. Thënë këtë, Gjykata gjithashtu thekson që Gjykata Supreme është po ashtu e detyruar që ligjin të interpretoj duke u bazuar në parimet që burojnë nga praktika gjyqësore e GJEDNJ-së sipas përcaktimeve të nenit 53 të Kushtetutës, dhe në rrethanat specifike të rastit konkret, anashkalimi i plotë i zbatimit dhe/ose arsytimit për moszbatimin të nenit 32 të LPK-së, duke u fokusuar vetëm në nenin 268 të LPK-së, për të vijuar në vlerësimin e vlerës së objektit të kontestit për secilën parashtrueseve veç e veç, në izolim të rrethanave specifike të rastit, ka rezultuar në interpretim dhe zbatim të ligjit në mënyrë tejet formaliste nga ana e Gjykatës Supreme, duke rezultuar gjithashtu në cenimin e të drejtës për qasje në drejtësi të palëve parashtruese të revizionit.
98. Gjykata rikujton se, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, vlerësimi i ankesave me një “*formalizëm të tepruar*” në vendimet e gjykatave të brendshme zakonisht është rezultat i shqyrtimit të rastit të marrë në tërësi (shih, [Bëlesh dhe të tjerët kundër Republikës Çeke](#), cituar më lart, paragrafi 69), gjithënjë duke pasur parasysh rrethanat e veçanta të atij rasti (shih, për shembull, [Stagno kundër Belgjikës](#), nr. 1062/07, aktgjykim i 7 korrikut 2009, paragrafët 33 - 35, dhe [Fatma Nur Erten dhe Adnan Erten kundër Turqisë](#), nr. 14674/11, aktgjykim i 25 nëntorit 2014, paragrafët 29-32). Në bërjen e këtij vlerësimi, Gjykata shpesh ka theksuar çështjet e “*sigurisë juridike*” dhe “*administrimit të duhur të drejtësisë*” si dy elemente qendrore për të bërë dallimin midis një “*formalizmi të tepruar*” dhe një zbatimi të pranueshëm të formaliteteve

procedurale. Në veçanti, ajo ka konstatuar se e drejta e qasjes në gjykatë cenohet kur rregullat pushojnë së shërbyeri qëllimeve të sigurisë juridike dhe administrimit të duhur të drejtësisë dhe formojnë një lloj pengese që e pengon palën ndërgjyqëse që çështja e tij/saj të vendoset në merita nga gjykata kompetente (shih, për shembull, [Kart kundër Turqisë \[DHM\]](#), nr. 8917/05, aktgjykim i 3 dhjetorit 2009, paragrafi 79 (ekstrakte); shih gjithashtu edhe [Efstathiou dhe të tjerët kundër Greqisë, nr. 36998/02](#), aktgjykim i 27 korrikut 2006, paragrafi 24, dhe [Eşim kundër Turqisë](#), nr. 59601/09, aktgjykim i 17 shtatorit 2013, paragrafi 21).

#### **(d) Konkluzioni i përgjithshëm**

99. Nisur nga sa më sipër, Gjykata konkludon se Aktvendimi i kontestuar i Gjykatës Supreme i 19 qershorit 2023, cenon të drejtat e parashtrueseve të kërkesës të garantuara me paragrafin 1 të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ-së. Thënë këtë, Gjykata konsideron se konstatimi i shkeljes së paragrafit 1 të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me paragrafit 1 të nenit 6 të KEDNJ-së, në rrethanat e rastit konkret ndërlidhet vetëm me parimin e qasjes në gjykatë, përkatësisht në Gjykatën Supreme dhe në asnjë mënyrë nuk e paragjykon rezultatin e meritave të rastit.
100. Gjykata po ashtu nënvizon se konkludimi i saj që Aktvendimi i kontestuar i Gjykatës Supreme, i 19 qershorit 2023, shkel të drejtat e parashtrueseve të kërkesës të garantuara me paragrafin 1 të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ-së, vlen vetëm në rrethanat e rastit konkret duke u bazuar në vlerësimin se interpretimi i nenit 32 (pa titull), në lidhje me nenet 211, 214 dhe 268 (pa tituj) të LPK-së nga ana e Gjykatës Supreme është jo proporcional sepse përfaqëson formalizëm të tepëruar. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se vlerësimi nëse veprimet e Gjykatës Supreme janë proporcionale me qëllimin legjitim të pragut ligjor *ratione valoris* përkitazi me garantimin e të drejtës për qasje në gjykatat më të larta, duhet të bëhet rast pas rasti dhe i njëjti vlen vetëm për rastin konkret bazuar në rrethanat e tij faktike dhe juridike.
101. Në fund, për sa i përket pretendimeve të parashtrueseve të kërkesës për shkelje të neneve 32 [E Drejta për Mjete Juridike] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës, Gjykata vlerëson se këto pretendime nuk do t'i nënshtrohen vlerësimit kushtetues për shkak se nuk ngrenë ndonjë çështje të re që nuk është trajtuar më parë në kuadër të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së (shih, rastin e Gjykatës [KI185/22](#) parashtrues *Salih Topalli*, cituar më lart, paragrafi 56 dhe referencat e përmendura aty).


## PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me paragrafët 1 të neneve 113 dhe 116 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit dhe rregullin 48 (1) (a) të Rregullores së punës, më 30 maj 2024:

### VENDOS

- I. TË DEKLAROJË, me 8 (tetë) vota për dhe 1 (një) kundër, kërkesën të pranueshme;
- II. TË KONSTATOJË, me 5 (pesë) vota për dhe 4 (katër) kundër, se ka pasur shkelje të paragrafit 1 të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 [E drejta për një proces të rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut;
- III. TË SHPALLË, me 5 (pesë) vota për dhe 4 (katër) kundër, të pavlefshëm Aktvendimin [Rev. nr. 216/2023], të 19 qershorit 2023, të Gjykatës Supreme të Kosovës;
- IV. TË KTHEJË, me 5 (pesë) vota për dhe 4 (katër) kundër, Aktvendimin [Rev. nr. 216/2023], të 19 qershorit 2023, të Gjykatës Supreme të Kosovës në rivendosje, në pajtim me konstatimet e Gjykatës në këtë Aktgjykim;
- V. TË URDHËROJË Gjykatën Supreme, që të njoftojë Gjykatën, në pajtim me paragrafin 5 të rregullit 60 të Rregullores së punës, për masat e ndërmarra për ta zbatuar Aktgjykimin e Gjykatës, jo më larg se më 2 dhjetor 2024;
- VI. TË MBETET e përkushtuar në këtë çështje në pajtim me këtë urdhër;
- VII. TË KUMTOJË këtë Aktgjykim dhe në pajtim me paragrafin 4 të nenit 20 të Ligjit ta publikojë atë në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës;
- VIII. TË KONSTATOJË se ky aktgjykim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, në pajtim me paragrafin 5 të nenit 20 të Ligjit.

Gjyqtari raportues

  
Radomir Laban



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

  
Gresa Caka-Nimani